

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7374 E martë 5 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Ndërsa i afrohem Presidencës bullgare të BE-së, e cila nis vitin që vjen dhe bëjmë bilancin e ndërveprimit të rritur midis vendeve të Ballkanit ...

Vijon në faqen 20

Nga DITMIR BUSHATI

Shqipëria 2018, drejt një hapi të madh



Opinion

Ditës

Nuk është e vërtetë se kombi shqiptar ka dy qeveri. Janë, në fakt, pesë, qeveritë që kanë punë me shqiptarët. Çdo nënvleftësim apo mospërfilje e kësaj të vërtete ...

Vijon në faqen 21

Nga ARIAN GALDINI

Për flamurin e një kombi dhe dy qeveritë e tij!



Kryeministri e kreu i PD, në Bruksel për negociatat

Anëtarësimi në BE, Tusk, Ramës: Në Këshill keni miq, ju mbështesim

Basha: Mes vendeve anëtare ka stepje. Bashkimi European, i shqetësuar për krimin

Nga DARINA TANUSHI & VALENTINA MADANI

Kryeministri Edi Rama u takua dje, pasdite me kreuin e Këshillit të Bashkimit European Donald Tusk. Me anë të një postimi në "Twitter". Donald Tusk e vlerësoi takimin si mjaft pozitiv, ndërsa kërkoi të mbahet ...

Në faqet 2-3

MINISTRIA E FINANCAVE PUBLIKON LISTEN E TRASHEGIMTAREVE QE MARRIN DEMSHPERBLIM

ISH-TE PERNDJEKURIT, 2000 EMRAT E RINJ QE PERFITOJNE

"Fëmijët dhe nipërit e ish-të burgosurve politikë që do të tërheqin këstin e parë dhe të dytë brenda tre muajve. Procedura që duhet të ndiqni"



(Në foto) Ish-të përndjekur në proteste

Në faqet 13-19

FLET MINISTRI GREK

Negociatat me Bushatin, Kotzias: Jemi drejt zgjidhjeve dypalëshe. Tërësisht ka ndryshuar kurs

Në faqen 12

SITUATA NE VEND

Përmbytjet, kreu i qeverisë: Siguroni banesat e bizneset, buxheti s'i mbulon dot

Në faqet 4-5

DEKLARATA

Xhafaj: Kemi hartën e shtrirjes së grupeve kriminale në Shqipëri, veting në polici

Në faqen 9

MBESHETJA

Kush janë 16 të rinjtë që 'pajtuar' qeverinë me Akademinë e Shkencave

Në faqen 11

ZBARDHEN DEBATET



Rezoluta kundër dhunës së grave në Kuvend, përplasen Berisha me Ballën

Në faqen 6

Shifrat, për 3 muaj në total janë dhënë 63 mijë leje për të punësuar

Gjermania lehtëson vizat e punës për Shqipërinë

Si të aplikoni në mënyrë të saktë dhe profesionet më të kërkuara

Nga VOLTIZA DURO

Punësimi në Gjermani po shihet si një mundësi tejet e mirë, veçanërisht për ata që nuk arrijnë të gjejnë një punë në vendet e tyre të origjinës. Nëse përmbushin ashtu si duhet kriteret e përcaktuara të përshtatsh-



mërisë, shtetasit jo gjermanë dhe ata që nuk janë anëtarë të BE-së, mirëpritur si fuqi punëtore e si një vlerë shtesë në ekonominë e demografinë gjermane. Në 8 muajt e parë të vitit 2017, Agjencia Federale e Punësimit në këtë shtet, ka lëshuar plot 63 mijë ...

Në faqen 7

**INTEGRIMI
TAKIMET**

Kreu i PD: BE e shqetësuar për krimin, zgjidhja është qeveria antimafie

Negociatat, Basha në Bruksel: Mes vendeve anëtare ka stepje

"Mbroytja e Tahirit dhe ikja e oficerëve, shije e hidhur"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, denoncoi dje në Bruksel lidhjet e pushtetit me krimin, ndërsa apeloj për krijimin e një qeverie antimafie, që sipas tij do të shkëpusë lidhjet e krimit me politikën dhe do garantojë zgjedhje të lira. Z.Basha ndodhet në Bruksel, në punimet e Asamblesë Politike të PPE. Ai pati atje takime me kolegë, drejtues të partive simotra dhe përfaqësues të qeverive europiane. Në një deklaratë nga Brukseli, zoti Basha analizoi krimin, korrupsionin dhe përdorimin e parave të drogës në ekonomi dhe politikë, si arsyet përse qeveria e Edi Ramës e ka vendosur Shqipërinë në një pozicion të pafavorshëm për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Kreu i PD paraqiti qeverinë antimafie, si zgjidhjen politike të opozitës, në kushtet kur ndërgjegjësimi i shumicës së vendeve anëtare për problemet e Shqipërisë për shkak të lidhjeve të qeverisë me krimin mund të çojë në situatën e papëlqyeshme për opozitën, atë të pengimit të rrugës europiane të vendit. "Për fat të keq, ajo që vërej është një stepje e madhe e përfaqësuesve të vendeve anëtare të Bashkimit Europian sa i përket Shqipërisë. Në vecanti, shqetësimet më të mëdha në drejtim të shtetit ligjor, luftës kundër krimit, luftës kundër korrupsionit. Padyshim që episodi "Tahiri" dhe mbroytja e tij politike me imunitet parlamentar, si dhe largimi në drejtim të paditur i 3 oficerëve madhorë, pasi ata u vunë nën akuzë dhe u kërkua arrestimi në lidhje me trafikun e drogës, kanë lënë një shije shumë të hidhur", deklaroi z.Basha. Sipas tij, avantazhi i të qenit në këtë takim është se vendet anëtare po ngrenë probleme që opozita ka 4 vjet që i denoncon, kriminalizimin e politikës, mbulimin e Sh-



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Bruksel

DENONCIMI

"Qeveria antimafie do të shkëpusë lidhjet e krimit me politikën, do të përgatisë një reformë të vërtetë zgjedhore dhe do ta çojë vendin me sukses drejt një qeverie legjitime përmes zgjedhjeve të lira", - tha z.Basha.



Kryeministri Edi Rama dhe kreu i opozitës, Lulzim Basha

"TË NDRYSHOJË SISTEMIN"

Aleatët e PD: Kodi Zgjedhor, antikushtetues

Dy prej aleatëve të PD-së, LZHK e drejtuar nga Dashamir Shehi dhe PDK e Nard Ndokës, mendojnë se përdorimi i teknologjisë në zgjedhje nuk i jep asnjë zgjidhje antikushtetueshmërisë, që prodhon sistemi aktual zgjedhor. Sipas tyre, ndryshimet në sistem do të diktojnë një hartë të re territoriale. Dashamir Shehi mendon se reforma zgjedhore duhet të ndërhyjë fort në sistem dhe jo të bëjë armine. Ndërsa, Nard Ndoka thekson se aktualisht Shqipëria ka një Kod Zgjedhor antikushtetues, sistemi proporcional rajonal, që ka probleme me përfaqësimin e votës - raporton TV "Klan". Në këtë kuadër, ata propozojnë që puna e Komisionit të reformës zgjedhore duhet të nisë nga ndryshimi i sistemit, për të cilin ata kanë edhe propozime konkrete. "Një mazhoritar proporcional, apo një sistem proporcional me gjashtë rajone, duke ulur edhe numrin e deputetëve nga 140 në 120", është një nga propozimet e dy prej aleatëve të PD-së. "Ndryshimet në sistem - thonë dy aleatët e Partisë Demokratike - diktojnë një hartë të re territoriale, si dhe rikthimin tek listat e hapura". Propozimet e aleatëve opozitarë vijnë në një kohë kur prioriteti i reformës zgjedhore për Partinë Demokratike është dekriminalizimi i zgjedhjeve, si dhe votimi e numërimi elektronik.

105-vjetori i krijimit, Presidenti uron FA

Meta: Kuvendi e qeveria, më tepër vlerësim ndaj ushtarakëve

Presidenti i Republikës, Ilir Meta uroi dje Forcat e Armatosura me rastin e 105-vjetorit të krijimit. Në mesazhin e publikuar nga zyra e Presidencës, Meta kujton se Forcat e Armatosura u krijuan vetëm pak ditë pas shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. "Angazhimi i Forcave të Armatosura dhe koordinimi i tyre me institucionet e tjera dhe autoritetet lokale është një garanci më shumë në ruajtjen e jetës së qytetarëve dhe minimizimin e dëmeve të pronës private dhe publike. 105-vjetori i krijimit të Forcave të Armatosura të Shtetit Shqiptar më jep mundësinë të konfirmoj edhe njëherë mbështetjen e palëkundur për zhvillimin dhe modernizimin e tyre. Ky moment historik më nxit gjithashtu që të inkurajoj Kuvendin e Shqipërisë, qeverinë dhe gjithë aktorët e tjerë në vend që të vlerësojnë dhe



MBËSHËTETJA

"Ky moment historik më nxit, gjithashtu, që të inkurajoj Kuvendin e Shqipërisë, qeverinë dhe gjithë aktorët e tjerë në vend që të vlerësojnë dhe trajtojnë me kujdes në rritje ushtarakët shqiptarë", - tha z.Meta.

trajtojnë me kujdes në rritje ushtarakët shqiptarë. Gëzuar 105-vjetorin e themelimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shprehet z.Meta. Po dje, presidenti takoi Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbroytjes (KLSM-2017), me pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Italia, Greqia, Turqia, Maqedonia, Rumania, Gjeorgjia dhe për herë të parë nga Mbretëria e Bashkuar. Presidenti ndau vlerësimin se Shqipëria

anëtare e NATO-s do përmblidhet me përkushtim e profesionalizëm të gjitha angazhimet, detyrimet dhe objektivat përballë sfidave të sigurisë. Presidenti theksoi se Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbroytjen do të vijojë të shërbejë për të promovuar vlerat e besueshmërisë, bashkëpunimit dhe përpjekjeve të përbashkëta drejt së ardhmes europiane dhe euroatlantike të vendeve të rajonit.

qipërisë me drogë, qindra milionë euro të drogës, që po qarkullohen nga grupe kriminale edhe përmes kanaleve të ekonomisë informale, duke i dhënë krimin

fuqi ekonomike dhe politike, siç u faktua në zgjedhjet e 25 qershorit. "PD i ka paralizuar këto, i ka bërë të ditura dhe ka kërkuar ndihmën e Bashkimit Europian, imsti-

tuacioneve të BE dhe vendeve anëtare. Disavantazhi është që shumica dërrmuese e vendeve anëtare janë bërë shumë të ndërgjegjshme për këto probleme. Kjo mund të pengojë

rrugën europiane të Shqipërisë duke ndëshkuar qytetarët shqiptarë, shumica dërrmuese e të cilëve nuk kanë lidhje as me kultivimin e drogës, as me trafikun e drogës, por janë ata që ndëjnë efektet e para negative, siç janë shtrëngesat e lëvizjes së lirë apo edhe kërcënimet në disa raste për kthimin e vizave për shqiptarët, siç është edhe skepticizmi i madh me të cilin po përballen vendet anëtare, sa i përket procesit të hapjes së negociatave me Shqipërinë", u shpreh z.Basha. Sipas tij, kjo është një gjendje jashtëzakonisht e papëlqyeshme për opozitën. "Natyrsh, interesi ynë është interesi kombëtar, interesi i qytetarëve shqiptarë, të

cilët nuk e meritojnë të ndëshkohen, të njolloseen, të damkosen për diçka që në fakt ka qenë një projekt i një grupi të ngushtë pushtetarësh dhe kriminelësh, me qëllim pushtetin dhe pasurimin e tyre. Zgjidhjet politike që opozita ka parashtruar janë në këndvështrimin tonë, edhe rruga që do të bënte të mundur avancimin e intereseve europiane të Shqipërisë. Kjo është zgjidhja e një qeverie antimafie, që do të shkëpusë lidhjet e krimit me politikën, që do të përgatisë një reformë të vërtetë zgjedhore dhe do ta çojë vendin me sukses drejt një qeverie legjitime përmes zgjedhjeve të lira e të ndershme", theksoi kreu i PD-së.



Kryeministri takon Presidentin e KE-së: Shqipëria shembull në krejt rajonin

Tusk pret Ramën në Bruksel: Të mbahet ritmi i reformave

Zyrtari i BE-së: Në Këshill keni vetëm miq, ju mbështesim

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama u takua dje, pasdite me kreun e Këshillit të Bashkimit Europian Donald Tusk. Me anë të një postimi në "Twitter", Donald Tusk e vlerësoi takimin si mjaft pozitiv, ndërsa kërkoi të mbahet ritmi i reformave. "Një takim i mirë me kryeministrin Edi Rama përpara Samitit të Ballkanit në 17 maj në Sofje. Nevojë që reformat për shtetin ligjor të vijnë me të njëjtin ritëm për të avancuar në rrugën drejt BE", -thuhet në mesazhin e Tusk, në "Twitter". Ndërkohë pas takimit që u zhvillua në kuadër të samitit që po mbahet në Bruksel, ishte vetë Tusk ai që ka publikuar një foto me Ramën. Ndërsa kryeministri Edi Rama gjatë takimit falënderoi presidentin Tusk që, siç u shpreh ai është një nga mbështetësit më të mëdhenj të përafërimit të mëtejshëm të Ballkanit, por edhe të Shqipërisë me Bashkimin Europian", -tha Rama. Më herët, kryeministri shqiptar shkroi



Kryeministri Edi Rama dje, me kreun e Këshillit të Bashkimit Europian Donald Tusk

DEKLARATA
"Dua të rikonfirmoj se ne e vlerësojmë vërtet procesin tuaj të thellë dhe mjaft të guximshëm të reformave. Ju jeni një nga shembujt më të mirë në rajon të kësaj ambicieje evropiane dhe të kësaj ëndrre evropiane", -theksoi Presidenti i Këshillit të BE-së, Donald Tusk.

AXHENDA

Kryeministri do të marrë pjesë sot, paradite në Samitin Western Balkans at a Crossroads, organizuar nga Friends of Europe. Në sesionin "Peace, Democracy and Reconciliation", Rama është i ftuar të mbajë një fjalë. Në orën 11:15 kreu i qeverisë pritet të zhvillojë një takim me Federica Mogherini, përfaqësuese e lartë e Bashkimit Europian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë.



PS-PD, konsensus për "axhendën 2030" të OKB-së: Të zhduket varfëria

Parlamenti miratoi mbremë me konsensus, me 112 vota "pro", rezolutën "Mbi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të axhendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara". Në shtatorin e vitit 2015 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm, të shtrirë deri në vitin 2030. Kjo marrëveshje bazohet mbi objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit, me qëllim zhdukjen e varfërisë dhe pabarazisë nëpërmjet bashkëpunimit mbarëbotëror. Relatorja e projektrezolutës, Eglantina Gjermeni u shpreh: "Qeveria shqiptare ka qenë një nga ato që e kanë konfirmuar dhe e kanë marrë angazhimin në OKB për axhendën 2030 dhe 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, që janë piketa zhvillimi për të gjitha shtetet anëtare". "Unë i konsideroj të 17 objektivat të rëndësishme, që shkojnë përshtat me procesin e integritetit të vendit, kështu që është detyrë e secilit prej nesh, që jo vetëm t'i shohim me seriozitet, por edhe të ndihmojmë në përmirësimin e tyre brenda afateve që do të vendosen", - u shpreh ish-ministria e Integritimit, Klajda Gjoshja. Kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashtme, Mimi Kodheli, e vlerësoi të rëndësishme që parlamentin jo vetëm të miratonte axhendën, por të punojë bashkë me institucionet e tjera, qeveri, shoqëri civile, që askush, grupe vulnerabel dhe grupe në nevojë, të mos mbeten pas.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Përmbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e pare për shitenj e pasurise se pakualtshme "Truali me sip. totale 200 m², nga te cilat 206 m² Ndertese, me Nr. Pasurise 554/3, Vol.5, Fq.183, Z.K.3070, e ndodhur ne Puke", si lene kolateral per garantimin e kredise, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit ProCredit Bank Sh. a., per shumen 1'822'310.51 (nje milion e tereqind e njetese e dy mije e treqind e dhjetete pike pesedhjetete e nje) Lekë.
Cmimi fillues me te cili fillon ankandi është ne shumen 1'354'656 (nje milion e treqind e pesedhjetete e kater mije e gjashteqind e pesedhjetete e gjashte) Lekë.
Ankandi zhillohet ne date 18.12.2017, ora 16.00 ne zyrane e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drita, kl.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyrajpermbarimi.com

derova që na dha mundësinë e këtij takimi me gjithë të gjendurit në një ditë shumë intensive takimesh me kryeministrin britanike. Po ashtu, dua t'i shpreh mirënjohjen që është një ndër mbështetësit më të mëdhenj të përafërimit të mëtejshëm të Ballkanit, por edhe të Shqipërisë me Bashkimin Europian", -tha Rama. Më herët, kryeministri shqiptar shkroi

në rrjetin social: "Në Bruksel me Presidentin e Këshillit Europian, Donald Tusk, i cili vlerësoi ecurinë e reformave kurajoze në Shqipëri, si një shembull pozitiv për krejt rajonin". Në ditën e dytë në Bruksel axhenda e kryeministrit Edi Rama parashikon gjatë pjesës së parë të ditës disa momente të rëndësishme. Në orën 09:00, kryeministri do të marrë pjesë në

Samitin Western Balkans at a Crossroads, organizuar nga Friends of Europe. Në sesionin "Peace, Democracy and Reconciliation" Kryeministri Rama është i ftuar të mbajë një fjalë. Në orën 11:15 kreu i qeverisë pritet të zhvillojë një takim me Federica Mogherini, përfaqësuese e lartë e Bashkimit Europian për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë.

Ministri i Jashtëm takon zv.presidentin e parë të KE-së

Bushati: Reforma transformuese në drejtësi është unike, po vihet në jetë

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati u takua dje, në Bruksel me zv.presidentin e parë të Komisionit Evropian, Frans Timmermans, si dhe Komisionerin Avramopoulos. Ministri Bushati bëri një analizë të detajuar të reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare për plotësimin e pesë përparësive kryesore të vlerësoi mbështetjen e Komisionit Evropian për axhendën evropiane të Shqipërisë. Ai nënvizoi se duke pasur parasysh progresin e bërë, qeveria pret që viti 2018 të jetë vit vendimtar për rrugëtimin evropian të Shqipërisë dhe në këtë kuadër, hapja e bisedimeve të anëtarësimit do të konsolidojë angazhimin e pandalshëm në transformimin dhe modernizimin evropianizues të vendit. Gjatë të dy takimeve, përfaqësuesit e Komisionit Evropian vlerësoan përkushtimin në vazhdimësi të Shqipërisë për axhendën e reformave. Në takimin me zv.presidentin Timmermans, ministri Bushati theksoi se reforma transformuese në drejtësi është unike dhe po vihet në jetë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët. Zv.presidenti inkurajoi vijimin e zbatimit të reformës në drejtësi, si themeli për forcimin e shtetit të së drejtës dhe përparimin e procesit të inte-



KOMISIONERI I BE
Komisioneri Avramopoulos vlerësoi masat e ndërmarra në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, veçanërisht rezultatet shumë pozitive të arritura në luftën kundër kultivimit të kanabisit.
Gjatë takimit me Komisionerin Avramopoulos, Ministri Bushati nënvizoi se rezultatet e prekshe të arritura në luftën kundër krimin të organizuar, veçanërisht në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, janë fryt i vendosmërisë për të forcur shtetin ligjor. Gjithashtu, ai theksoi se vullneti politik dhe angazhimin i qeverisë për të forcur sundimin e ligjit janë të palëkundur dhe të pakthyeshmë.

DEMET NGA PERMBYTJET HETIMET

Përmirësohet situata në jug, bora krijon probleme Shkodër, Pukë e Kukës

Kallëzimi i banorëve për përmbytjen, katër prokurori nisin verifikimin

Në "sitë", dëmet e shkaktuara në banesa dhe biznese në rrethet Tiranë, Krujë, Vlorë dhe Fier

Ndërprerja e reshjeve ka çuar në përmirësimin e situatës në jug të vendit, ku dëmet e shkaktuara nga moti i keq janë shumë të mëdha. Tashmë vëmendja është përqendruar në veri të vendit, pasi dëbora ka bllokuar disa zona të thella. E ndërsa po punohet intensivisht për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga shuia e shirave të ditëve të fundit, mësohet se 4 prokurorinë e rretheve Tiranë, Krujë, Fier e Vlorë kanë nisur verifikimin e denoncimeve të bëra nga qytetarët, të cilëve iu dëmtuan bizneset dhe pronat. Sipas "abcnews.al", dhjetëra banorë kanë bërë kallëzim për dëmtimin e banesave dhe bizneseve gjatë përmbytjeve të së enjtes dhe së premtes. Pas kallëzimit, prokurorinë e rretheve në fjalë kanë nisur verifikimin në zonat e pushtuara nga uji, ku në sitë do të kalojnë të firmat kontraktuale për mirëmbajtjen e akteve rrugore, si ato kombëtare edhe rurale. Ndërkaq, prokuroria e Krujës ka nisur hetimet për shembjen e urës që lidhte Qafshatamën me këtë qytet. Kjo, për faktin se ura është ndërtuar pak kohë më para dhe normalisht duhet të kishte përballuar përmbytjet.

HETIMET
Shumë biznese VIP u përmbytën përgjatë autostradës Tiranë-Durrës. Prokuroria e Tiranës është ende në fazën fillestare të verifikimit të dëmeve të shkaktuara në autostradë. Mësohet se aktualisht po mbledhet dokumentacioni përkatës e më pas organi i akuzës do të shprehjet nëse ka apo jo shkelje ligjore. Gjithashtu, prokuroria bën me dije se nisja e verifikimit për kompanitë përgjegjëse, të cilat kishin si detyrë mbajtjen hapur të kanaleve kulluese e po kështu të asistimit me mjetet e tyre gjatë situatës së reshjeve, do të shkrihet edhe më tej. Ku do të verifikohet edhe mënyra se si i kanë fituar tenderat publikë dhe a kanë staf e mjete logjistike përkatëse për të përballuar situata emergjente. Ndërko-



Borëpastrueset në Kukës

DIBËR

Reshjet e dendura të shiut të ditëve të fundit kanë sjellë probleme në disa zona të vendit. Si pasojë e motit të keq dhe reshjeve, shkolla në Kalanë e Dodës, në Dibër ka pësuar plasaritje dhe për pasojë është pezulluar mësimi për 50 nxënës të kësaj shkolle. Sipas shefit të Emergjencave Civile në Dibër, shkak i plasaritjeve të shkollës ka qenë rrëshqitja e tokës nga prurjet e shumta të përrenjve.



FA në ndihmë të banorëve të Ferrasit në Fier

KUKËS

Bashkia e Kukësit dje bëri me dije se pas ndërhyrjes në rrugën e dëmtuar të Çajës (tek Përroi i Gjicit), është rikthyer qarkullimi normal i mjeteve. Ndërsa po punohet fshatin Lojme, për të siguruar qarkullimin e mjeteve. Sipas bashkiakëve, energjia elektrike është rikthyer në pjesën dërrmuese të fshatrave dhe po punohet nga grupet e OSSHE-së për linjat e dëmtuara edhe në ato zona ku ende mungon energjia. Mësohet se dëbora në zonat malore të Kukësit arrin në 35 cm.

MASR: Të mërkurën rihapen dhe 3 të tjera

Përmbytjet nga moti i keq, rinis procesi mësimor në 13 shkolla të vendit

Ditën e sotme ka rinisur normalisht procesi mësimor për 13 shkolla në vend, të cilat kishin pezulluar punën për shkak të dëmtimeve nga përmbytjet. Njoftimi është publikuar pasditen e së djeshmes në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Rinisë e Sporteve, e cila bën me dije se 3 shkolla të tjera do të rifillojnë procesin mësimor ditën e mërkurë, në datën 6 dhjetor të këtij viti pasi ende po punohet për rikthimin e tyre në gjendje optimale. Respektivisht bëhet fjalë për shkollën "Thoma Sema" në Levan, "Rakip Kryeziu" në Fier dhe "Ismail Qemali" në Vlorë për të cilat po vazhdon ende procesi i punimeve deri në rikthimin e tyre në gjendje optimale për realizimin e orëve mësimore.

**DITËN E MARTË, DATË 05.12.2017
RIFILLOJNË PROCESIN MËSIMOR KËTO**

- Shkolla 9-vjeçare Gjysylkane (Pezë, Tiranë Qark)
- Kopshti Ndroq (Ndroq, TIRANË QARK)
- Shkolla Dritas (Nj. Adm. Zall Herr, Tiranë Qark)
- Shkolla Niko Hoxha (Valias, Tiranë Qark)
- Xhevit Fetahu (Levan, Fier)
- Bocove (Levan, Fier)
- Pishë (Levan, Fier)
- Cikli i Ulët Çerven (Frakull, Fier)
- Cikli i Ulët Kashisht (Frakull, Fier)
- Kafil Malaj (Bishan, Novoselë, Vlorë)
- Loni Mone (Poro, Njësia Novoselë, Vlorë)
- Qeriba Derri (Bashaj, Njësia Brataj, Bashkia Selenicë, Vlorë)
- Sadik Zotaj (Ramicë, Njësia Brataj, Bashkia Selenicë, Vlorë)

DITËN E MËRKURË, DATË 06.12.2017 DO TË RIFILLOJË PROCESIN MËSIMOR NË SHKOLLAT:

- Thoma Sema (Levan, Fier)
- Rakip Kryeziu (Bashkia Fier, Fier)
- Ismail Qemali (Fitore, Novoselë, Vlorë)

hë, denoncime janë kryer edhe në prokurorinë e Fierit dhe Vlorës. Banorët pretendojnë se përmbytjet e banesave të tyre kanë ardhur si rezultat i mosfunksionimit të kanaleve kulluese, detyrë që i takon firmave nënkrotaktore. Edhe në këto qytete dëmet janë të mëdha, ku qindra shtëpi banimi dhe

toka bujqësore u dëmtuan si rezultat i përmbytjeve. Zyrtarisht, Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile njoftoi se janë 590 familje të evakuuara dhe 1552 persona të shpëtuar. Po kështu, 4715 banesa e 41 biznese u dëmtuan. Dëmet të konsiderueshëm ka edhe në bujqësi, ku si rezultat u përmbytën 10 622 ha.

Ndërsa 27 shkolla, këtë të hënë nuk e fillojnë mësimin për arsye të kushteve të përpshatshme.

SITUATA NË VERI

Pas përmirësimit të situatës në jug të vendit, vëmendja është përqendruar në veri, ku reshjet e borës kanë bllokuar disa akse rrugore. Që prej tri ditësh, bora ka

Mbillen 200 pemë të reja për parandalimin e erozionit dhe përmbytjeve

Për të parandaluar erozionin dhe përmbytjet nga reshjet e dendura, Bashkia e Tiranës në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit ka mbjellë plot 200 pemë të tjera në kryeqytet. Kjo nisim vijon në kuadër të projektit për krijimin e Pyllit Orbital të Tiranës i cili parashikon mbjelljen e 100 mijë pemëve brenda një viti. Kryebashkiaku Erion Veliaj u shpreh i kënaqur për ecimin e projektit, duke shtuar se ky është investimi më i mirë për të parandaluar fenomenet natyrore me të cilat u përball vendi ditët e fundit. "Në shumë zona rurale, nga përmbytjet dhe shirat e fundit, kanë rrëshqitur kodrat, aty ku është prerë një pemë, aty ku janë hequr shkurret, aty ku është zhdukur bimësia. Dua t'i ftoj të gjithë qytetarët, kush do të bëjë diçka konkrete mjafton të mbjellë një pemë, një shkurre, mjafton të mos presë ato që ekzistojnë", -tha Veliaj. Më tej, ai nënvizoi se Bashkia e Tiranës, nga ana e saj, do të vazhdojë gjatë gjithë periudhës së dimrit, deri në pranverë, me mbjelljen e pemëve, ndërsa theksoi se një rol në pëllëzimin dhe gjelbërimin e Tiranës mund të luajë kushdo.



bllokuar disa rrugë në zonën e Dukagjinit. Në Qafë-Thore trashësia e borës është rreth 50 cm dhe po në këtë nivel është edhe në rrugët Selcë-Vermosh, Shosh-Shalë, Qafa Shllak-Qafë Mali. Në rrugën e Thetit ka rrëshqitje gurësh dhe dherash dhe dalje të përrenjve, ndaj ky aks është i pakalueshëm. Kurse

në shumë në fshatra mungon energjia elektrike dhe uji i pijshëm. Në Malësinë e Madhe rrugët janë të kalueshme me zinxhirë, kurse Bogë-Qafë Thore është e pakalueshme. Në Pukë reshjet e borës kanë qenë me të pakta dhe ekipet borëpastruese po mbajnë situatën në kontroll.



Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ishte edhe dje në Darzëzë të Fierit, atje ku u ndërtua në kohë rekord ura e dëmtuar nga përmbytjet e ditëve të fundit. Në një komunikim për mediat, Xhaçka pohoi se tashmë strukturat duhet të jenë të mobilizuara, pasi fillon një fazë e re, që është pastrimi i territorit. "Nga menaxhimi i mirë dhe puna e FA ka qenë garancia për të menaxhuar këtë situatë nga përmbytjet. Këto janë ditë të vështira, të gjithë duhet të jemi të mobilizuar. Mirënjohje për punën e FA në krah të NATO-s dhe të gjitha operacionet e tjera. Bravo ju qoftë! Këtu kanë qenë 500 efektivi, ndërtuam në kohë rekord urë. E përballuam shumë më mirë se në 2015-ën. Bashkëpunimi me institucione lokale ka qenë shumë i mirë, pasi falë këtij bashkëpunimi është bërë e mundur që

Ministria e Mbrojtjes: Nisim fazën e dytë, pastrimin e territorit

Xhaçka: Përmbytjet, përballuam situatën më mirë se në vitin 2015



Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka dje në Darzëzë të Fierit

kemi këtë rezultat. Nuk do të lëmë asnjë pa e ndihmuar, tani fillon faza e dytë, ajo e pastrimit të territorit dhe ndihmën për çdokënd", tha Xhaçka. Kjo deklaratë përkon me 105-vjetorin e krijim-

it të Forcave të Armatosura. Duke kujtuar 105-vjetorin e krijimit të FA, Xhaçka tha se pjesëtarët e ushtrisë që duhet të ishin duke festuar apo kujtuar këtë ditë të rëndësishme, sot janë në misione

nëpër bote, ose janë pranë qytetarëve, të cilët janë në nevojë për shkak të përmbytjeve. "Sot (dje) duhet të ishte një ditë kujtimi dhe pse jo festive për Forcat e Armatosura. Është 105-vjetori i krijimit të kësaj ushtrie, por për shkak të përmbytjeve dhe reshjeve apo misioneve të shumta ku është angazhuar FA, pjesëtarët e FA nuk janë duke festuar, por disa prej tyre janë në Afganistan, disa në Letoni, Mali etj. Por, ka edhe nga ata që sot janë këtu e që për net me radhë, duke ndënjur pa gjumë, u janë gjendur qytetarëve shqiptarë në momentet e vështira të përmbytjeve", tha Xhaçka.

Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile: Llogari bankare për të ndihmuar të dëmtuarit

Përmbytjet, kryeministri: Siguroni banesat e bizneset

"Do të marrim nismë ligjore, nuk mbulohen të gjitha nga buxheti"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama deklaroi se duhet përcaktuar me ligj siguri i banesave dhe bizneseve, pasi në raste përmbytjesh nuk mund të financohen të gjitha detyrimet nga buxheti i shtetit. Në mbledhjen e djeshme të Komitetit të Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, që u drejtua prej tij, para nisjes për në Bruksel, Rama u shpreh: "Është përparësi marrja e nismës ligjore për sigurimin e banesave dhe të bizneseve nga përmbytjet. Jemi ende i vetmi vend që nuk ka një masë të tillë me ligj dhe ku pastaj, njerëzit e prekur mbeten në mëshirë e fatit dhe në pritje vetëm nga buxheti i shtetit, që nuk mund të përballojë gjithçka dhe gjithmonë, edhe pse këtë herë, ne do t'i përballojmë si edhe herën e kaluar, të gjitha detyrimet që burojnë nga kjo krizë e rëndë. Por - shtoi kreu i qeverisë - është shumë e rëndësishme që të gjithë qytetarët, të gjithë sipërmarrësit të stabilizohen dhe të kuptojnë se duhet si në çdo vend normal të marrin masa, të sigurohen nga fatkeqësitë natyrore, në mënyrë që dëmet e tyre të kompensohen plotësisht dhe në kohë reale në bazë të



Kryeministri Edi Rama gjatë mbledhjes së djeshme me Komitetin e Koordinimit të Emergjencave Civile

AGRON SHEHAJ

Deputeti i PD-së në Vlorë reagoi dje pas premtimit të kryeministrit Rama se do të dëmshpërblehen banorët e prekur nga përmbytjet. "Këta banorë të përmbytur në 2015-ën u mashtruan dhe akoma po presin kompensimin e premtuar nga Rama. Sot Rama bën shfaqjen e radhës dhe iu premtom kompensim për 2017-ën", - shkroi ai.

këtij mekanizmi". "Natyrisht, për sa na takon, ne do të bëjmë maksimumin, siç kemi bërë edhe herën e shkuar, ku nuk kemi lënë askënd pa kompensuar deri në fund për dëmet që ka pasur", tha më tej Rama. Kryeministri uroi dje, 105-vjetorin e Forcave të Armatosura, duke vlerësuar edhe punën që ata bënë, gjatë ditëve të përmbytjeve. "Tani është momenti për të cuar

përpara fazën e dytë, atë të kapërcimit të pasojave, në radhë të parë për familjet e prekur dhe sigurisht, për ato pjesë të infrastrukturës që janë jetike për lëvizshmërinë dhe për garantimin e vazhdimet të jetës normale në komunitet e zonave të përmbytura", vuri në dukje Rama. "Do të na duhet më tej që të ecim me zbatimin e planit që ka nisur prej disa muajsh nga ministri i Bujqësisë,

Opozita

"Edi Rama duhet ta lërë propagandën e t'u zgjidhë hallet mijëra familjeve, që janë prej tri ditësh pa ujë, pa ushqime e drita! Edi Rama duhet t'i dëmshpërblejë për humbjet e pallogaritshme që kanë pësuar, pasi dimri është i gjatë dhe i papërbullueshëm në këto kushte". - u shpreh dje kryetari i PD-së, Basha.



LULZIM BASHA

për të ndërhyrë në të gjitha pikat e dobëta të sistemit të mbrojtjes nga uji, në bashkëpunim me ministrin e Infrastruktursë. Fakti i shembjes së një numri të konsiderueshme urash flet qartë për potencialin katastrofik që kishte kjo situatë, nëse shumë investime mbrojtëse nuk do të ishin bërë në këto dy vjet. Nga ana tjetër, e kemi parë qartësisht se në çdo zonë ka ende një sërë pikash të dobëta, ku duhet ndërhyrë me përparësi", bëri të ditur kryeministri.

DEKLARATA

Komiteti arriti në përfundimin se faza e parë është përmbyllur me sukses të plotë dhe se qëllimi i vënë për të shpëtuar jetën e qytetarëve të rrezikuar, u arrit më së miri falë an-

gazhimit, përkushtimit, sakrificës të të gjithë njerëzve të përfshirë në operacione dhe organizmit shumë të mirë të tyre. Pas kalimit të fazës së parë, tashmë është kaluar në fazën e dytë, e cila ka për qëllim kapërcimin e gjendjes së krijuar, lehtësimin e pasojave dhe rikthimin e normalitetit në jetën dhe veprimtarinë e qytetarëve apo subjekteve të prekur, bëhet me dije pas mbledhjes së komitetit. Komiteti vlerëson solidaritetin e shfaqur nga qytetarët dhe bizneset dhe bën thirrje që në ditët në vijim kjo frymë të thellohet edhe më tej. "Për të lehtësuar procesin e kontributeve financiare në dobi të të prekurve nga përmbytjet, janë vënë në dispozicion llogari rrjedhëse bankare në

disa banka të vendit. Të gjithë ata që kanë mundësi për të ndihmuar në lehtësimin e problemeve të krijuara për qytetarët janë të inkurajuar që të kontribuojnë, qoftë edhe në mënyrë modeste, për këtë qëllim. Edhe një ndihmë sado e vogël ka një efekt shumë të madh solidar, për të cilin kanë nevojë të gjithë personat e prekur. Kontributet që do të mblidhen në këtë rrugë do të shkojnë vetëm në përfitim të individëve të prekur", thuhet në deklaratën e Emergjencave Civile. "Autoritetet shtetërore do të vijojnë me intensitet të pandryshueshëm përpjekjet për të dhënë ndihmën e nevojshme, për të vlerësuar dëmet si dhe për të filluar sa më parë procesin e zhvendimeve dhe kompensimeve. Kryeministri i vendit ka dhënë detyra për të rritur edhe më tej shpejtësinë dhe thellësinë e zbatimit të programit të investimeve për mbrojtjen e infrastrukturës kritike të vendit si argjinatura, diga, kanale kulluese, ura, rrugë etj., me qëllim që vendi të përgatitet plotësisht për të përballuar fatkeqësi natyrore, denduria e të cilave duket se është në rritje për shkak që lidhen me edhe me ndryshimet klimatike", thuhet në njoftimin e mbledhjes së komitetit të emergjencave.

PARLAMENTI REZOLUTA

Kuvendi voton me konsensus kundër dhunës ndaj grave, 111 vota pro rezolutës

Debati, Berisha: Të vijë Rama. Ballë: Po bën pakt me Bashën!

Ish-kryeministri: Tre agresorët brutalë

Valentina Madani

Kuvendi miratoi mbrëmë me konsensus mes mazhorancës dhe opozitës rezolutën e paraqitur nga PD-ja për dhunën ndaj grave. 111 deputetë votuan pro saj me asnjë votë kundër. Në seancën e posaçme plenare për dhunën ndaj grave, dje munguan kryeministri Edi Rama dhe kreu i opozitës Lulzim Basha, por edhe pa praninë e tyre, deputetët nuk shmangën dot debatin e ashpër mes tyre. Protagonistë ishin ish-kryeministri Sali Berisha dhe kreu i deputetëve socialistë Taulant Balla, të cilët e nisën seancën me batuta dhe ironi teksa flitej për "dënimin e fenomenit të dhunës në familje dhe marrjen e masave urgjente për evidencimin e situatës dhe gjetjen e mekanizmave efikas ligjorë për parandalimin e këtij fenomeni". Në nisje të seancës, ish-kryeministri Sali Berisha kërkoi prezencën e Ramës në Kuvend, duke akuzuar atë se ka dhunuar gratë. "Ai që mbahet për miziken nuk është këtu, por nxin edhe me mosqenien këtu. Duhet të jetë këtu dhe të kërkojë falje Violeta Manushit për ato që i ka thënë, ku është?", tha Berisha. Por i menjëhershëm ishte reagimi i kreut të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, i cili iu përgjigj me ironi Berishës, se Rama ndodhet me Bashën në Bruksel, ku po bëjnë marrëveshje. "Është në Bruksel me Lulzim Bashën dhe po bëjnë marrëveshje", iu drejtua Balla, Berishës. Ish-kryeministri vuri në dukje se krahas murit të patriarkisë, tre janë agresorët më brutalë ndaj gruas shqiptare. Së pari, largimi masiv i burrave dhe djemve në emigracion. Së dyti, droga dhe së treti, vjedhja masive e fondeve. "Unë jam sot për të paraqitur një nga rastet më flagrante të vjedhjeve të 220 milionë eurove të vërtetuara. Ju bej thirrje ju, de-



Seanca e djeshme parlamentare

REZOLUTA E PD KËRKON:

- Mbikëqyrje të fortë parlamentare dhe trajtim të denoncimeve për dhunën në familje;
- Brenda 15 ditëve Kuvendi krijon komision të posaçëm për trajtimin ligjor të fenomenit;
- Brenda 60 ditëve qeveria të bëjë analizën, të paraqesë të dhënat, të krijojë Regjistrin Kombëtar për dhunën në familje;
- Përcaktim me ligj të një strukture të vetme përgjegjëse me qëllim parandalimin e dhunës dhe garantimin e mbrojtjes së viktimave;
- Përfshirim me ligj nga amnistia dhe nga rrethanat lehtësuese gjatë gjyqimit për krimet në familje;
- Rishikim për masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje për moslejimin e bashkëjetesës në një mjedis të dhunuesit dhe viktimës;
- Rishikimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimës dhe vënien në dispozicion të mjeteve të nevojshme për rastet e rrezikut për jetën, duke mirëpërcaktuar detyrimet e Policisë së Shtetit, përcaktimin e personave përgjegjës që marrin përsipër të mbajnë nën kontroll dhunuesin, si dhe aplikimin gjerësisht të mbikëqyrjes elektronike për rastin e dhunuesve brenda familjes.

putetë të PS, t'i marrin këto dokumente dhe të më thonë se cilat fjalë dhe shifra mund ta justifikojnë. Afera është më plehrë se çdo plehrë. Në kohën e përmbvjetjeve, kjo qeveri me Ramën dhe Arben Ahmetajn, brenda një dite

bëjnë nëntë veprime të kundërligjshme dhe ia japin tenderin një famozi, Klodian Zoto, njeriut të Ahmetajt. Ky zotëri e merr me 22 milionë djegësin e Elbasanit, po ky zotëri e shet koncesionin me 16 milionë euro një ital-

iani dhe fut në xhep, 7 milionë euro nga taksapaguesit shqiptarë. Unë ju them ju se kjo nuk ndodh kurrë nëse nuk është kryeministri dhe ministri i financave nuk janë në tavë dhe vjedhin si ujëqerë të pangopur taksat e sh-



Ish-kryeministri Sali Berisha

VOTIMI

Kuvendi miratoi mbrëmë me konsensus mes mazhorancës dhe opozitës rezolutën e paraqitur nga PD-ja për dhunën ndaj grave. 111 deputetë votuan pro saj me asnjë votë kundër.

Debati



AKUZAT

Në nisje të seancës, ish-kryeministri Sali Berisha kërkoi prezencën e Ramës në Kuvend, duke akuzuar atë se ka dhunuar gratë. Por i menjëhershëm ishte reagimi i kreut të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, i cili iu përgjigj me ironi Berishës, se Rama ndodhet me Bashën në Bruksel, ku po bëjnë marrëveshje.

Seanca për dhunën në familje

Majlinda Bregu: Basha s'ka faj, parlamenti ta trajtojë seriozisht



nuk është vetëm dhunë në familje dhe të zgjedhurit e partive politike në parlament, nuk besoj se mund edhe të mos dënojnë një krim, i cili po bën hata ndër gra e fëmijë në Shqipëri. Parlamenti sot duhet të kërkojë e nxisë shpalljen e luftës kundër dhunës me bazë gjinore, prioritet kombëtar", shprehet znj. Bregu.

ky për sa kohe të jetojë në mohim të realitetit, s' do pranojë se ka faj asnjëherë dhe për asgjë. Do të doja gjithashtu, që parlamenti në fund të kësaj seance të mos mjaftohet me "dënimin e fenomenit të dhunës në familje", një nga pikat e kërkesës së PD. Dhuna ndaj grave nuk është vetëm dhunë në familje dhe të zgjedhurit e partive politike në parlament, nuk besoj se mund edhe të mos dënojnë një krim, i cili po bën hata ndër gra e fëmijë në Shqipëri. Parlamenti sot duhet të kërkojë e nxisë shpalljen e luftës kundër dhunës me bazë gjinore, prioritet kombëtar", shprehet znj. Bregu.

qiptarëve. Më ka thënë një mik i shquar amerikan, avokat, kam pasur shumë miliarderë hajdutë për t'i mbrojtur në gjyq, dhe nuk kishte asnjë prej tyre që nuk donte të vidhte miliardin tjetër. Nga djegësi i Elbasanit

tek djegësi i Fierit, ia dhanë prapë Klodian Zotos me 28 milionë euro. Po çfarë bëri ai, ia shiti italianit me 15 milionë euro. Dhe tani me këtë në Tiranë. Në kundërshtim flagrant me çdo lloj procedure", theksoi z. Berisha.

VIZA PUNESIMI GJERMANI

Lehtësim i procedurave për shqiptarët e kosovarët, cilat janë profesionet më të kërkuara

Si të aplikoni për vizë pune në Gjermani

Ja cili është kushti i vetëm që ju shpall juve fitues

Voltiza Duro

Punësimi në Gjermani po shihet si një mundësi tejet e mirë, veçanërisht për ata që nuk arrijnë të gjejnë një punë në vendet e tyre të origjinës. Nëse përmeshin ashtu si duhet kriteret e përcaktuara të përshatshmërisë, shtetasit jo gjermanë dhe ata që nuk janë anëtarë të BE-së, mirëprehen si fuqi punëtore e si një vlerë shtesë në ekonominë e demografisë gjermane. Në 8 muajt e parë të vitit 2017, Agjencia Federale e Punësimit në këtë shtet, ka lëshuar plot 63 mijë viza punësimi, pra shifrat janë rritur me 70%. Sipas statistikave, një në tre viza pune për vendet e treta, i ka kaluar një aplikanti nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Që prej fillimit të 2016-ës, për aplikantët nga Shqipëria, Kosova apo Bosnjë-Hercegovina, procedurat janë lehtësuar e tashmë të interesuarit mund të kërkojnë një vend pune, por duke plotësuar kushtet përkatëse. Kushti i vetëm që i jep të drejtën e përfitimit të një vize pune në Gjermani është sigurimi i një oferte konkrete pune në këtë shtet. Kandidatëve nuk u kërkohet një kualifikim minimal apo pagë minimale, sikurse ndodh në rastin e së ashtuquajturës Blue Card, që është e parashikuar për specialist.

PROFESIONET E KËRKUARA

Shumicën e rasteve, vizat e punës janë dhënë për punëtorë në fushën e ndërtimit, por Gjermania thekson se ka nevojë për krahu pune edhe në sektorin e gastronomisë, të shërbimeve dhe të kujdestarisë për të moshuarit. Për të siguruar një kontratë pune në këtë shtet, aplikanti ka mundësi të mëdha në internet pasi operojnë kanalet të ndryshme online



PROFESIONET

Shumicën e rasteve, vizat e punës janë dhënë për punëtorë në fushën e ndërtimit, por Gjermania thekson se ka nevojë për krahu pune edhe në sektorin e gastronomisë, të shërbimeve dhe të kujdestarisë për të moshuarit.

me informacion të zgjeruar mbi vendet e hapura të punës në Gjermani. Të interesuarit mund të kontrollojnë vazhdimisht në faqen zyrtare të Agjencisë Federale të Punësimit, por edhe në portalet vendore të punës. Këto të fundit ofrojnë ka sesione informacioni ose panairë për vendet e lira të hapura për punësim. Pasi kandidati të ketë zgjedhur punën e preferuar në Gjermani, më pas duhet të përgatitet për të aplikuar. Kompanitë gjermane mund të kërkojnë prej aplikantëve aplikimin për punë në një formë kopje të shtypur me postë. Megjithatë, shumë aplikime për punë në Gjermani bëhen edhe online.

Një punësim fitimprurës në Gjermani përfshin mbajtjen e një leje pune, si një dokument autorizues që i jep leje për të bërë pjesë e tregut gjerman të punës. Në mënyrën e marrjes së lejes së punës, mbajtja e një leje qëndrimi është një detyrim, si një dokument autorizues që lejon individin të banojë në Gjermani. Përa disa kohësh, emigrantët ishin të detyruar të aplikojnë për punë dhe leje qëndrimi në dy autoritete të ndryshme, por së fundmi procedura është thjeshtuar dhe harmonizuar përmes miratimit të një direktive të vetme: lejes së Bashkimit Evropian. Mbajtja e një leje të vetme autorizon ligërisht shteta-

KUSHTI
Sipas statistikave, një në tre viza pune për vendet e treta, i ka kaluar një aplikanti nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Që prej fillimit të 2016-ës, për aplikantët nga Shqipëria, Kosova apo Bosnjë-Hercegovina, procedurat janë lehtësuar e tashmë të interesuarit mund të kërkojnë një vend pune, por duke plotësuar kushtet përkatëse. Kushti i vetëm që i jep të drejtën e përfitimit të një vize pune në Gjermani është sigurimi i një oferte konkrete pune në këtë shtet. Kandidatëve nuk u kërkohet një kualifikim minimal apo pagë minimale.

sit e jashtëm të punojnë dhe banojnë në vendet e BE-së, përfshirë Gjermaninë, përmes një procedure të vetme aplikimi për një autoritet të vetëm.

STATISTIKAT NGA AGJENCIA FEDERALE E PUNËSIMIT

Në 8 muajt e parë të vitit 2017, Agjencia Federale e Punësimit në këtë shtet, ka lëshuar plot 63 mijë viza punësimi, pra shifrat janë rritur me 70%. Një në tre viza pune për vendet e treta, i ka kaluar një aplikanti nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Për aplikantët nga Shqipëria, Kosova apo Bosnjë-Hercegovina, procedurat janë lehtësuar.

DOKUMENTACIONI

- Një letër motivimi, pra një letër drejtuar kompanisë ku do të punojë
- Një foto aplikimi.
- Kurrikulum CV (të përkthyer në gjermanisht).
- Leja e vetme aplikohet për dy kategori të shtetasve të huaj:
- Shtetasit jo të BE që synojnë të hyjnë në Gjermani për punë dhe vendbanim,
- Shtetasit jo të BE-së, që tashmë banojnë në Gjermani me qasje në punë në Gjermani

Konsultime për personat nën 27 vjeç

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet aplikantët

Aplikimi është hapi i parë në tregun e punës. Një rëndësi të veçantë ka edhe dokumentacioni që kandidati paraqet për të aplikuar për një kontratë pune në shtetin gjerman. Të gjithë të interesuarve iu nevojitet një letër motivimi, pra një letër drejtuar kompanisë ku do të punojë, një foto aplikimi, kurrikulum CV (të përkthyer në gjermanisht). Madje ofrohen edhe workshops mbi aplikimet për punë në Gjermani ku kandidati mund të informohet në mënyrë të detajuar si të bëni një aplikim të suksesshëm dhe si të përgatiteni për intervistën e punës. Në momentin që ju e fitoni vizën e punës, do të informoheni edhe mbi kohëzgjatjen e punës që do të kryeni në Gjermani. Në shërbimin për migracionin e të rinjve, ofrohen konsultatë të posaçme për të gjithë personat nën 27 vjeç. Ajo çka mund të jetë e dobishme për të interesuarit që duhet të sigurojnë një kontratë pune në shtetin gjerman, është edhe praktika në një firmë apo kompani ku individit njihet me punën, por njëkohësisht krijon edhe kontakte.

APLIKIMI

Të gjithë të interesuarve iu nevojitet një letër motivimi, pra një letër drejtuar kompanisë ku do të punojë, një foto aplikimi, kurrikulum CV (të përkthyer në gjermanisht). Madje ofrohen edhe workshops mbi aplikimet për punë në Gjermani ku kandidati mund të informohet në mënyrë të detajuar si të bëni një aplikim të suksesshëm.

Permbuesi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shtipje në ankand pasurine :
*Toka Are truall nr pasurie 222/11, vol 4 , faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trust , Njësia Administrative Berdise , bashkia Shtikoder
Cmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërshpikuar , është në vlerën 736,000 (shtatëqind e tridhjetë e gjashtëmijë) lekë
Shitja e pasurisë do të behet (zhvillohet) me date 07.12.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbuesit gjyqësorë Gentil Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Ferballe Gjakales se rrethit Gjyqësorë Shtikoder. Personat e interesuar duhet te derdhen para para fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shtikoder me nr llogarite 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE TIRANË**
Zyra e Përmbarimit Tirane me permbueses gjyqësor Albert Fejzo, ne baze le vendimit nr. 10484, date 30.11.2017 , shpall shpallen ne ankand te pasurise apartamentin te banimit me siperfaqe 57 m2 te ndodhur ne Rrugën: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 ne Zonen kadastrale 8260 te regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurise Pallatishme Tirane me nr pasurie nr 254-4-60, volumi 6, faqe 82 Tirane , ne vleren duke filluar nga 2.800.000 (dy milion e teteqind mije) Lekë.
Ankandi zhvillohet me ambjentet e Zyres te Përmbarimit Tirane , ne adresen : Shteshi Mustafa Alaturk , Kryeqezimi " 21 Dhjetori", Tirane dite e Premte , me date 15.12.2017 , ora 16.00.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND
Ne date 06.12.2017 ne oren 16:00 ne zyren e permbuesit gjyqësor privat Irista Terëziu PF
Me adrese ne : Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, njësia Tregtare nr. 10 Tirane, zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit " Njesi " me siperfaqe totale 87.2 m2 , numer pasurie, 15/231 -N1, vol.2014 - 2016, ne zonen kadastrale 8551 me adrese Kavaje. Cmimi ne ankand te dyte është ne vleren 5.830,887.52 (pesë milion e teteqind e tridhjetë mije e gjashtëqind e tete dhjetë e shtate oikë

Kriminalë shqiptarë, të cilët po shlyejnë dëmin e tyre në burgjet britanike janë shfaqur në disa video të postuar nga vetë ata, duke tymosur kanabis në këto ambiente. Në një shkrim ekskluziv të saj, e përditshmja britanike "The Sun" shkruan se së fundmi kanë dalë imazhe që tregojnë se brenda burgjeve britanike, të dënuarit shijojnë një jetë luksoze, në vend



"The Sun": Të dënuarit shijojnë një jetë luksoze në qeli

Kriminalët shqiptarë tymosin kanabis në burgjet angleze

që të vuajnë. "The Sun" thotë se ka në zotërim video që tregojnë anëtarë të bandës famëkeqe Hellbanianz, me bazë në Barking, në lindje të Londrës duke kërcyer e duke konsumuar kanabis në qeli. Sipas së përditshmes britanike, gjatë javës së kaluar një grup i bandës Hellba-

nianz dyshohet se u përfshi në një zënkë masive në sheshin Trafalgar të Londrës, ku ishin mbledhur për të festuar Festën e Pavarësisë. Në video, që "The Sun" zotëron, shfaqet një person që po kërcen muzikë rap dhe po konsumon kanabis. Videoja është postuar në pro-

filin e një personi të quajtur Skilla, i cili shkruan: "Shqiptarët edhe të kyçur e të rrethuar nga mure të larta janë luanë". Një tjetër postim tregon dy persona duke konsumuar kanabis, ndërsa shkruhet: "Ne jemi zotët e rrugëve. Në burg kemi gjithçka, e vetmja gjë

që na mungojnë janë prostitutat". Ndërsa në një tjetër video në "Instagram", shkruan më tej "The Sun", sërisht nga brenda burgut, shkruhet: "Bishat të mbylur në burgje si Alkatraz, e vetmja gjë që i mungon janë vajzat. Në një prej komenteve, shqiptarët sulmojnë edhe familjen mbretërore britanike: "Në djall qeveria dhe mbretëresha... dua t'i shoh të gjithë shqiptarët jashtë burgut".

"Materialet u janë deleguar për hetim prokurorëve të tjerë"

Zhdukja e tri dosjeve hetimore në Elbasan, informohet ambasada e SHBA

Prokuroria: Fashikujt janë marrë me procesverbal

TIRANE

Ambasada e SHBA in formohet për zhdukjen e tri dosjeve të rëndësishme në prokurorinë e Elbasanit. Më herët vetë prokurorja Armanda Xhaferri ka bërë denoncimin në polici, pasi ka konstatuar se në zyrën e saj kishin humbur 3 fashikuj të procedimeve penale. Bëhet fjalë për dy dosje për pastrim parash dhe një për abuzim me fondet e një rruge, materiale të mbërritura nga Njësia Task Forcës për hetimin e korrupsionit. Burime nga policia bën me dije se konstatimi i mungesës së fashikujve në zyrën e saj është bërë nga vetë prokurorja Xhaferri, disa ditë më parë. Një grup hetimor i ngritur enkas për zbardhjen e kësaj ngjarje të rëndë, ka kqyruar zyrën e



prokurores Xhaferri, por nuk ka konstatuar thyerje nga jashtë. Ditën e djeshme kallëzimi i prokurores së Elbasanit Armanda Xhaferri i është vënë në dispozicion edhe ambasada e SHBA-së në Tiranë. Kjo çështje më

shumë se sa një ngjarje kriminale, është një konflikt mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurores që ka denoncuar zhdukjen, deklarim "Top Channel". Burime nga prokuroria e Elbasanit bëjnë me dije se dosjet që Amanda Xhaferri i ka denoncuar si të zhdukura nga zyra e saj, në fakt, janë marrë me procesverbal dhe u janë deleguar për hetim prokurorëve të tjerë të Njësies Task Forcë Kundër Krimin Ekonomik dhe Korrupsionit. Më konkretisht, mësohet se drejtuesi i prokurorisë së Elbasanit, Dritan Gina i ka hequr prokurores Amanda Xhaferri disa dosje me argumentimin se për një kohë të gjatë nuk kishte kryer veprimet hetimore dhe këto dosje ia ka deleguar për hetim prokurorëve të tjerë. Në zbatim të këtij vendimi të drejtuesit të prokurorisë,

janë tërhequr edhe fizikisht dosjet nga zyra e prokurores Xhaferri për në zyrat e prokurorëve që kanë marrë në dorëzim çështjet, por ky fakt nuk është pranuar nga prokurorja Amanda Xhaferri.

Dhunoj fëmijët në kopshtin privat, 5 muaj e 20 ditë burg për edukatoren

TIRANE - Edukatorja e një kopshti në Tiranë, Denida Rexhepi e arrestuar për dhunë ndaj fëmijëve gjatë ushtrimit të detyrës së saj, është dënuar nga Gjykata e Tiranës me 5 muaj dhe 20 ditë burgim. Edukatorja Rexhepi u filmua teksa dhunonte fëmijët në një kopesht privat. 30-vjeçarja u shpall fajtoreshë për veprën penale të "Keqtrajtimit të të miturve". Denida Rexhepi u arrestua më 4 qershor të këtij viti nga policia, pasi u akuzua për rrahjen e dy fëmijëve të mitur në kopshtin ku punonte. Arrestimi i saj u bë pas kallëzimit të bërë nga prindërit e dy fëmijëve të keqtrajtuar, J.B. dhe M.L., të cilët kanë thënë se në datat 30 maj 2017 dhe 31 maj 2017, Rexhepi ka ushtruar dhunë fizike ndaj fëmijëve të tyre të mitur në kopshtin privat ku punonte. Në pamjet filmike, sipas prokurorisë, shihet qartë se ish-edukatorja ka keqtrajtuar fëmijët e mitur, duke i goditur ata dhe duke i fyer.



Njoftim i ALBtelecom Sh.a.

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së lëvizshme se duke filluar nga data 15 dhjetor 2017:

1. Do të ofrojë dy paketa të reja 4 javore për të gjithë pajtimtarët me parapagesë:

a. Paketa Super 1300 do të përbëjë: 2,500 minuta të vlefshme drejt operatorëve kombëtarë; 2,500 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 20 minuta ndërkombëtarë; 250 SMS kombëtarë/ndërkombëtarë; 8 GB Internet; të përdorshme përkatësisht 5 GB me shpejtësi 3G/4G dhe 3 GB vetëm me shpejtësi 4G; si edhe ALBtv Mobile dhuratë; të vlefshme për 28 ditë; me çmim 1,300 Lekë (me TVSH).

b. Paketa Super 1900 do të përbëjë: 3,000 minuta të vlefshme drejt operatorëve kombëtarë; 3,000 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 60 minuta ndërkombëtarë; 300 SMS kombëtarë/ndërkombëtarë; 11 GB Internet; të përdorshme përkatësisht 8 GB me shpejtësi 3G/4G dhe 3 GB vetëm me shpejtësi 4G; si edhe ALBtv Mobile dhuratë; të vlefshme për 28 ditë; me çmim 1,900 Lekë (me TVSH). Abonentët të cilët e aktivizojnë këtë paketë përfitojnë paketën më të re të internetit EXTRA me 10 GB internet falas.

2. Paketa ekzistuese 4 javore Super 1000 për numrat me parapagesë do të ndryshojë dhe njësitë e përfshira në këtë paketë do të jenë: 1,000 minuta drejt operatorëve kombëtarë; 1,000 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 100 SMS kombëtarë/ndërkombëtarë; si edhe 6 GB Internet; të vlefshme në shpejtësitë 3G/4G; me vlefshmëri 28 ditore; me çmim 1,000 Lekë (me TVSH).

3. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën 1000 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin këtë paketë të pandryshuar deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së kësaj pakete.

4. Paketat ekzistuese 4 javore Super 500-1 dhe Super 700 do të mbeten të pandryshuara.

5. Paketat 4 javore Super 500-2, Super 1200, Super 1500 dhe Super 2000 nuk do të ofrohen më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë njërin prej këtyre paketave aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin ato deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.



Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

-"Pyll", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 82, regjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyzeli-BLB" sh.a, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 15,120,000 Lekë.

-"Pyll", me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 81, regjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Ermira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2167 Rep., Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 2,520,000 Lekë.

-"Trull", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² trull dhe 161 m² ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumni 4, faqe 247, regjistruar në pronësi të Armand Shuapi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 2173 Rep, Nr. 1409/2 Kol, datë 24.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 3,133,065.6 Lekë.

-"Arë+Trull", me sipërfaqe 4,500 m², nga e cila 400 m² trull dhe 176 m² ndërtesë, ndodhur në Sallimone, Durrës, me Nr. 178/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumni 6, faqe 135, regjistruar në pronësi të Bujar Gjyzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipoteke Nr. 657 Rep, Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipoteke Nr. 1512 Rep, Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 9,534,672 Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.12.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiffs Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

KRIMI NE VEND DOSJA "HABILAJ"

Konferenca rajonale, ministri i Brendshëm: Tolerancë zero në luftën kundër krimit

Xhafaj: Kemi një hartë të shtrirjes së grupeve kriminale në Shqipëri

"Vetë, shumë shpejt do të shihen rezultatet e para"

Në konferencën rajonale, e cila zhvilloi ditën e djeshme kundër krimit të organizuar, ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj tha se operacioni "Forca e ligjit", i ka dhënë frytet e tij, njëloj si lufta kundër kanabisit dhe vetingu në polici. Ministri Xhafaj deklaroi se faza e parë e operacionit "Forca e ligjit" ka përfunduar me identifikimin e grupeve kriminale, lidhjet e tyre, aktivitetin, pasuritë, investimet e kryera si dhe zonat e influencës. Ai kujtoi se së shpejti priten rezultatet e reformës në drejtësi. "Vetë operacioni "Forca e Ligjit", pjesë e planit të veprimit që ka miratuar qeveria shqiptare, ka si komponentë të tij të rëndësishëm krijimin e një databaze të plotë të dhënash dhe mbi të gjitha skanimin e të gjitha grupeve kriminale, lidhjet e tyre brenda dhe jashtë vendit, aseteve që zotërojnë etj.", u shpreh ministri i Brendshëm. Sakaq Xhafaj foli edhe për tre ish-drejtesit e lartë të Policisë së Shtetit që vijojnë të jenë në arrati si të dyshuar për lidhjen me grupin e Habilajve. "Policia e Shtetit ka detyrën për të bërë këtë gjë dhe unë besoj që është duke e bërë", u shpreh Xhafaj.

DEKLARATA E XHAFAJT

Qeveria shqiptare muajin e kaluar ka miratuar një plan veprimi për luftën kundër krimit të organizuar - Operacioni "Forca e ligjit", i cili ka si objektivi pikërisht këtë, goditjen e grupeve kriminale dhe aseteve të tyre të paligjshme. Kjo nisim, ka një qasje gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare. Ka përfunduar faza paraprake, ajo e katalogimit të grupeve kriminale me të dhëna për persona, lidhjet e tyre kriminale, aktivitetet e rënda kriminale të dyshuara se kryhen prej tyre, pasuritë që zotërojnë, investimet ekonomike të bëra me të ardhura nga aktiviteti kriminal, zonat e ndikimit, lidhjet me grupe të tjera jashtë vendit apo mbështetjet e siguruar në vite për të lehtësuar veprimtarinë e tyre. Tashmë ka filluar edhe veprimi konkret dhe rezultatet e para janë pozitive.

Ne tashmë kemi një tabelë të qartë se ku shtrihen ky aktiviteti kriminal, cila është veprimtaria që ushtrojnë këto grupe nga pikë-



Konferenca Rajonale

"FORCA E LIGJIT"

Ministri Xhafaj deklaroi se faza e parë e operacionit "Forca e ligjit" ka përfunduar me identifikimin e grupeve kriminale, lidhjet e tyre, aktivitetin, pasuritë, investimet e kryera si dhe zonat e influencës. Ai kujtoi se së shpejti priten rezultatet e reformës në drejtësi.

"Qeveria ka bllokuar rastin e ish-ministrit të Brendshëm"

Media franceze për drogën në Shqipëri: Vazhdojnë hetimet për Saimir Tahirin

Mediat franceze kanë reaguuar për çështjen "Tahiri" në Shqipëri nëpërmjet një artikulli. Courrierdesbalkans.fr shkruan se hetimet janë në vijim dhe vetëm javën e kaluar në Greqi u kap një sasi e madhe droge, që sipas mediave greke është e miqve të ish-ministrit të Brendshëm. "Pavarësisht nga presioni ndërkombëtar, qeveria e Edi Ramës bllokoi rastin Tahiri. Kjo qeveri ka mbështetur ish-ministrin e Punëve të Brendshme, të akuzuar për lidhje me trafikantët e drogës. Ndërsa hetimi vazhdon, arrestime të mëdha u bënë javën e kaluar në Greqi", shkruhet te Courrierdesbalkans.fr. Ndërkohë ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri akuzohet nga prokuroria për trafik të lëndëve narkotike të kryer në bashkëpunim. Kërkesa zyrtare e Prokurorisë së Përgjithshme për heqjen e imunitetit, arrestimin dhe kontrollin e banesës së ish-min-

pamja e territorit dhe ndërlidhjes me to dhe rrezikshmëria që kanë.

Operacioni "Forca e ligjit" nuk është i shkëputur nga nisimat e tjera të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit. Operacioni antiknabis gjatë 2017 me rezultatet tejet pozitive të arritura na ndihmoi të hedhim



MEDIA FRANCEZE

"Pavarësisht nga presioni ndërkombëtar, qeveria e Edi Ramës bllokoi rastin Tahiri. Kjo qeveri ka mbështetur ish-ministrin e Punëve të Brendshme, të akuzuar për lidhje me trafikantët e drogës. Ndërsa hetimi vazhdon, arrestime të mëdha u bënë javën e kaluar në Greqi", shkruhet te Courrierdesbalkans.fr.

istrin Saimir Tahiri mbështet sipas prokurorisë në përgjimet telefonike të dyshuarve Habilaj si dhe në faktin që Tahiri ka udhëtuar me të dyshuarin Artan Habilaj dhe persona të tjerë me mak-

hapa konkretë në kufizimin e të ardhurave të këtyre grupeve nga kultivimi apo trafikimi i kanabisit. Vetë, shumë shpejt do të shihen rezultatet e para. Reformimi i sistemit të Policimit në Komunitet do të na ndihmojë të kthejmë be-

sinin e qytetarëve të institucioneve të sigurisë. Të gjitha janë pjesë e një programi unik prioritësh me një moto të vetme: Tolerancë zero në luftën kundër krimit, nga institucione të forta me njëri-tjetër dhe me integritet, në shërbim të qytetarëve. Këto nisim vijnë në kohën e duhur, mbësht-

etën dhe janë në sinkron me procesin e reformës në drejtësi që ka hyrë në fazën e saj më të rëndësishme: Vetë, shumë shpejt do të shihen rezultatet e para të këtij procesi, si dhe në fazën e ngritjes së institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

zyrtarë të lartë të Policisë së Shtetit, ku si person i dyshuar është edhe ish-ministri i Brendshëm, person nën hetim Saimir Tahiri, "thuhet në kërkesën e prokurorisë. Prokuroria ngre dyshimet se Tahiri ka qenë në dje të veprimtarisë kriminale të Moisi Habilajt dhe të gjithë anëtarëve të tjerë të kësaj bande dhe ka siguruar paprekshmërinë e veprimtarisë kriminale të tyre. "Personi në hetim Moisi Habilaj, në bashkëpunim me persona të tjerë, duke përfutur nga lidhjet e ngushta me ish-ministrin e Brendshëm dhe kundrejt shpërbërësve kanë bërë të mundur kultivimin e sasive të konsiderueshme të lëndës narkotike, transportimin e tyre në mënyrë të organizuar me destinacion jashtë vendit", thuhet në kërkesën e prokurorisë.

prokurorëve se prej vitesh jetonte dhe punonte në Itali, por vinte shpesh në Shqipëri, për të vizituar prindërit në shtatin Gjorm. Për këtë shkak u gjend në Vlorë, ku dhe u arrestua për llogari të prokurorisë së Katanas, me akuzën e trafikut të drogës në bashkëpunim.



50 ditë të tjera burg për financierin e Habilajve

TIRANE - Gjykata e Tiranës ka shtyrë me 50 ditë të tjera afatin e masës "Arrest në burg" për qellim ekstradimi të Nezar Seitit. Ky i fundit kërkohet nga drejtësia italiane pasi dyshohet si financier i grupit të Habilajve. Seiti kërkoi shuarje të masës së sigurisë, për shkak të përfundimit të afatit 20 ditor, ndërkohë që shtyrja e re me 50 ditë është ankumuar në Apel. Më herët ndaj Seitit janë dhënë dy masa me afat nga 20 ditë për arsye ekstradimi dhe një masë "Arrest me burg" për hetimin e tij nga Krimet e Rënda. Më herët Seiti ka shfaqur vullnetin për t'u ekstraduar në Itali, ku kërkon të përballet me akuzat e trafikimit të drogës nga Shqipëria në drejtim të Italisë. Sipas hetimeve të prokurorisë së Katanas, Seiti është personi që shpërndante fitimet që vinin nga aktiviteti kriminal, jo vetëm mes anëtarëve të grupit "Habilaj", por edhe bashkëpunëtorëve që ndihmonin në realizimin e trafikut të narkotikëve, apo armëve. Gjithashtu, më herët, Nezar Seiti ka shpjeguar përpara oficerëve gjyqësorë lidhjen e tij me familjen Habilaj. Ai ka treguar se me Habilajt bashkëshortja e tij i ka kushurinj. "Me shtetasit Artan, Moisi dhe Florian Habilaj, kam lidhje krushqie, pasi bashkëshortja ime i ka kushërinj. Moisi më vizitoi kur kreu një ndërhyrje në Itali. Vëllezërit i kam takuar kur jam kthyer në Shqipëri. Me Moisin dhe Florianin takohem rrallë, ndërsa me Artanin më shpesh", ka shpjeguar Nezar Seiti. I arrestuar mbrëmjen e 19 tetorit, më herët Seiti ka rrëfyer para prokurorëve se prej vitesh jetonte dhe punonte në Itali, por vinte shpesh në Shqipëri, për të vizituar prindërit në shtatin Gjorm. Për këtë shkak u gjend në Vlorë, ku dhe u arrestua për llogari të prokurorisë së Katanas, me akuzën e trafikut të drogës në bashkëpunim.

Arrestohet edhe një shqiptar, iu gjet drogë në makinë

Kokainë për VIP-at, shkatërrohet banda e shqiptarëve në Itali, 11 persona në pranga

ITALI - Policia italiane ka shkatërruar dhe një bandë shqiptarësh, të cilët akuzohen se furnizonin me kokainë klientë VIP. Mediat italiane raportojnë se në pranga kanë përfunduar 11 persona, ndërkohe që nuk bëhet i ditur identiteti i tyre. "Valdarno post" shkruan se organizatori ishte një person me masën e sigurisë "detyrim parajtijë". Mes të tjerash, mediat italiane shkruajnë se rrjeti i krijuar nga shqiptarë merrte 'porositë' përmes telefonit dhe më

GREQI

Policia greke ka zhvilluar një operacion antidrogë, ndërsa ka arrestuar një vajzë shqiptare, e cila është kapur me lëndë narkotike. Mësohet se policia ka ndaluar autobusin e linjës Kakavijë-Janinë, pranë kryqëzimit të Kallapaqit, pas informacioneve se një person kishte lëndë të dyshuara. Gjatë kontrollit, në çantën e 24-vjeçares shqiptare u gjetën 7 kg e 550 gr marijuanë. Gjithashtu u sekuestrua droga dhe një celular, ndërsa vajza u shoqërua në komisarariat.

pas bënin dorëzimin e mallit tek banesat e klientëve VIP. Po ashtu, bëhet e ditur se për porositë dhe dërgesat përdorehin kode të caktu-

ara. Mësohet se klientët ishin sipërmarrës, biznesmenë, ndërsa qëllimi i tyre ishte kokaina e pastër. Ndërkohë, për një dozë çmimi i ko-



Droga e sekuestruar nga policia italiane

identiteti i të cilit ende nuk bëhet i ditur. Sipas mediave të vendit fqinj, shqiptari ka filluar të shfaqë shenja nervozizmi, duke detyruar patrullën që të kryejë kontroll në makinën e tij, duke i gjetur edhe lëndën narkotike prej gjysmë kilogramë kokaine. Sipas autoriteteve, kokaina ishte e një cilësie të pastër, por nuk u tregua vlera me të cilën mund të shitej në treg. Po ashtu, gjatë kontrollit në banesë shqiptarit i gjendet edhe një tjetër sasi e ndarë në doza dhe e gatshme për t'u shitur në treg.

kainës varioonte deri në 60 euro, ndërsa në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 350 gr kokainë, 500 gr marijuanë si dhe 500 doza të gatshme. Ndërkaq, në një operacion tjetër të zhvilluar në qytetin Albisola në Itali, policia vendëse ka mundur të vërë në pranga një shtetas shqiptar. Gjatë një kontrolli rutinë në rrugë, karabinierët ndaluan 50-vjeçarin shqiptar,

SHKURT

Sekuestrohen 2 kg heroinë në Bari, kapet kamionisti shqiptar

ITALI - Policia e Barit sekuestroi dhe 2 kg heroinë, e cila ishte fshehur në një kamion që vinte nga Shqipëria. "Bari Today" shkruan se droga u zbulua nga Guardia Di Finanza gjatë një kontrolli në portin e Barit. Mësohet se në pranga ka rënë kamionisti, një shqiptar, identiteti i të cilit nuk dihet. Mediat italiane raportojnë se heroina ishte pako celofani, ndërkohe që ishte fshehur poshtë sediljes së shoferit.

Kërkohej nga Kroacia për mashttrim ekonomik, prangoset tetovari

QAFË THANË - Një 61-vjeçar nga Tetova është arrestuar nga shërbimet e Policisë Kufitare në Qafë-Thanë, pasi rezultonte person në kërkim ndërkombëtar. Ruzhdi Muharemi nga Tetova rezultoi i dënuar me 5 vite burg në Kroaci për "Mashttrim ekonomik". Ai është ndaluar dy ditë më parë, teksa po hynte në Shqipëri. 'Ndaj këtij shtetasi, autoritetet gjyqësore në Varazdin, Kroaci, kanë lëshuar urdhër arrestin ndërkombëtar numër 30 K-289/12-29, datë 04.05.2016 për veprën penale "Mashttrim ekonomik". Maksimumi i dënimit është 5 vite burgim", thuhet në njoftimin e policisë.

Dy në pranga, për heroinë e kundërshtim të forcave të policisë

SARANDE - Policia e Sarandës dhe e Delvinës ka arrestuar 2 persona, pasi akuzohen për vepra të ndryshme penale. Blutë e Sarandës prangosën Ibrahim D., 38 vjeç, banues në Sarandë, pasi gjatë një kontrolli policor i janë konstatuar 2 doza heroinë. Gjithashtu, policia e Delvinës ka arrestuar Ardian S., 46 vjeç, pasi ka kundërshtuar forcërisht punonjësit e policisë të Komisarariatit Delvinë gjatë kryerjes së detyrës. Materialet iu referuan Prokurorisë së rrethit Gjyqësor Sarandë për veprime të mëtejshme.

DURRËS

Një tjetër pajisje që dyshohet se kryen përgjime ka hyrë në mënyrë të paligjshme në territorin shqiptar. Mbrëmjen e së dielës, autoritetet policore në Portin e Durrësit kanë shoqëruar shtetasin italian Giambattista Intrini, i cili po dilte nga Shqipëria me një pajisje të dyshuar si përgjuese. Sipas policisë, gjatë kontrollit 47-vjeçarit iu gjet një aparat elektronik dhe dyshimtë, e cila është dërguar për ekzaminim në laboratorin shkencor. Ndërkohë, burime nga policia e qytetit bregdetar dhe bënë me dije se italiani, i cili shoqërohej nga një femër (Ana Maria Tevrtini) do të hetohet në gjendje të lirë. Burime nga grupi hetimor thanë për gazetën se 47-vjeçari kishte ardhur para pak ditësh në Shqipëri dhe mbrëmjen e së dielës po largohet drejt Italisë me tragetin e linjës Durrës-Bari. Por, gjatë kalimit në pikën kufitare, policia zbuloi pajisjen e dyshimtë dhe shoqëroi në komisarariat dy shtetasit italianë. Pas marrjes në pyetje, italiani Intrini është shprehur se është inxhinier uji, ndërsa kjo pajisje shërben për të matur cilësinë e ujit. 47-vjeçari nuk ka pranuar të tregojë se nga kush autoritet publik apo agjenci private është kontraktuar për të ofruar shërbimet e tij. Do të jetë ekspertiza që do të konfirmojë se për çfarë shërben realisht pajisja që u gjet në posedim të italianit.

DËSHMIA E ITALIANIT

"Kam ardhur në Shqipëri pak ditë më parë dhe po largohem për në vendin tim. Kam ardhur bashkë me zonjën (shoqëruesen), pasi do të negociohim me një firmë uji të pijshtëm. Unë jam inxhinier ujërash dhe kjo pajisje nuk është ashtu si mendoni ju (për përgjime), por shërben për matjen e cilësisë së ujit. Merreni dhe verifikojeni. Është thjeshtë një pajisje që më shërben për profesionin tim. Nuk kam të drejtë të jap më shumë shpjegime. Nuk ka rëndësi kush janë

Policia: Dyshojmë se kryen përgjime, u dërgua në laboratorin shkencor për ekspertizë

I gjendet një pajisje e dyshimtë në port, nën hetim 47-vjeçari italian

Giambattista Intrini: Shërben për të matur cilësinë e ujit

PRECEDENTET

Kjo nuk është hera e parë që shtetas të huaj ndalohen me pajisje të dyshimta. Në mars të këtij viti u ndalua në Rinas izraeliti Yoram Frig. Po në aeroport, në këtë periudhë u ndalua greku Joannis Dragounis pas dyshimeve se ai lëvizte me pajisje të dyshuar përgjuese. Në të dyja rastet pas ekspertizës u konfirmua se pajisjet nuk kryenin përgjime.



Pajisja sekuestruar nga policia e Durrësit

eporë e mi. Siç u thashë, jam inxhinier dhe kjo që po më ndodh këtu nuk është aspak normale. Nëse nuk njihni aparatet e matjes së cilësisë së ujit, ky është problemi juaj. Unë dua të largohem menjëherë nga Shqipëria, pasi unë dhe kolegja ime jemi shumë të irrituar me situatën e krijuar", ka pohuar Giambattista In-

trini. Pavarësisht deklaratës së 47-vjeçarit italian, policia vijon hetimet për pajisjen që aktualisht është dërguar për ekspertizë në laboratorin shkencor.

HETIMET

Burime pranë grupit hetimor dhe bënë me dije se deklarimet e shtetasit italian janë të rreme, pasi pajisja duket që kryen shërbime të

tjera elektronike, që nuk kanë lidhje me cilësinë e ujit. Sipas këtyre burimeve, 47-vjeçari kishte disa ditë që qëndronte në qytetin e Durrësit dhe se ai ka qenë kontradiktor në reagimin e tij para oficerëve të policisë. "Nëpërmjet sistemit TIMS kemi zbuluar se ata kishin ardhur pak ditë më parë në vendin tonë nëpërmjet

pikës kufitare të portit të Durrësit. Kemi dyshime se italianu po fsheh diçka, pasi pajisja duket qartë se nuk ka funksion matjen e cilësisë së ujit. Pajisjen elektronike e kemi çuar për ekspertizë në laboratorin shkencor, i cili do të zbulojë funksionin e saj. Paraprakisht dyshojmë se është një pajisje përgjimi, por sikurse theksova, do të jetë laboratorin shkencor, ai që do të tregojë se për çfarë shërben realisht kjo pajisje elektronike. Ndërkohë po mbajmë nën monitorim dhe po hetojmë në gjendje të lirë 47-vjeçarin nga Italia", thanë hetuesit e çështjes. Aktualisht, policia dhe prokuroria po kërkojnë informacione nga Italia për shtetasin e kapur në portin e Durrësit me pajisjen e dyshimtë. Nga të dhënat e para, sipas policisë, ai rezultoi person i paskeduar nga policia italiane dhe nuk është në listën e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpoli.



Foto ilustruese

DURRËS - Gjykata e Apelit të Durrësit dhe ka konfirmuar masën e "arrestit me burg" për 10 të arrestuarit e akuzuar për tjetërsim toke në Spille. Ata akuzohen se kanë tjetërsuar 36 ha tokë në Spille, duke falsifikuar firmat e disa banorëve të kësaj zone dhe më pas përpilonin certifikatat e pronësisë. Prokuroria ka zbuluar se përfuttes të pronave në Spille janë të afërm dhe familjarë

Hajdutët e tokave në Spille, Gjykata e Apelit lë në burg 10 zyrtarët e lartë

të drejtuesve dhe ish-drejtes të pushtetit lokal, ish-kryetarit të Bashkisë së Kavajës Elvis Rroshi dhe ish-kryetarit të PS, Gentiajn Daja. Sipas Prokurorisë së Kavajës, ka rezultuar se të gjitha këto pasuri të kthyera dhe regjistruara në emër të

personave të ndryshëm me ndërrim të zërit kadastral nga "tokë pa frut" ose "pyll" në "tokë bujqësore" dhe në vijim të ndara me Akte të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), në fakt janë ende ranishte në breg të detit ose pyll. Më pas, këto pasuri të

regjistruara në emër të shtetasve të ndryshëm, sipas AMTP janë tjetërsuar (shitur) me anë të kontratave noteriale tek blerës të dytë ose të tretë. Për këto arsye ngrihet dyshimi i bazuar se të gjitha praktikat për regjistrimin e pasurive në parcelat nr.1, 35, 37 dhe 178 të ZK 3501 ndodhur në Spille Kavajë (bregdeti) janë bazuar në dokumentacione tërësisht të falsifikuara.

KONFERENCA

Akademikët e rinj "pajtojnë" qeverinë me Akademinë nënë

Fatmira Nikolli

Mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe qeverisë, prej shtatorit lufta vazhdon herë në heshtje e herë publikisht.

Ndërsa kryeministri u ka lënë afat akademikëve që të reformohen duke kërkuar rithemelim të Akademisë, dhe një flamur i bardhë paqeje u valëvit, ose u duk si i tillë. Teksa mbahej konferenca e parë mbarëkombëtare shkencore e Akademisë së Rinjve, organizim i krijuar nga Akademia e Shkencave, ministria e Arsimit, Lindita Nikolla mori pjesë në nisjen e takimit, duke ofruar mbështetje dhe ekzekutivitet për ta. "Lejomëni që jo vetëm t'u përgëzoj, por edhe t'u shpreh gjithë mbështetjen edhe të kryeministrit të Shqipërisë për këtë nismë tejet me vlerë, të shkëlqyer që do të shënjojë një ecuri të re për gjithë atë që në bashkërisht po zhvillojmë, si një reformë që ka përfshirë të gjithë sistemin e shkencës në vend", deklaroi para akademikëve të rinj, ministria Nikolla. Akademia e Rinjve pranë Akademisë së Shkencave u ngrit në qershor të këtij viti, me cilësinë e një komisioni të përhershëm novacioni, me kërkues të rinj të vlerësuar në një proces konkurrimi. Shkencëtarët e rinj kanë aderuar edhe në Akademinë Botërore të Rinjve. Të suksesshëm e të spikatur në fushat e tyre, 16 janë anëtarët e saj: Andi Rëmbeci (Universiteti i Tiranës, Belfiore Qose (Univ. i Tiranës), Edelajda Cenaj-Cepa (Univ. "A. Xhuvani"), Erida Gjini (Instituto Gulbenkian de Ciencia, Portugal) Eris Rusi (Univ. "Fan Noli"), Ilda Kazani (Univ. Politeknik i Tiranës), Mentor Beqa (UET), Mikaela Minga (QSA), Nebi Bardhoshi (QSA), Rigers Baku (Univ. Bujqësor i Tiranës), Shaniko Allajbeu (Univ. "Ismail Qemali"), Sokol Çunga (Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave), Teuta Toska (U. "Aleksandër Xhuvani"), Thomas Frashëri (Kabineti i kryeministrit), Valbona Sota (Univ. Tiranës) dhe Xhaklina Cani (Univ. Tiranës).

KONFERENCA

Konferenca e kërkuesve të rinj, "Metodologjia dhe kërkimi shkencor: traditë dhe risi" u organizua me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në kuadër të veprimtarive për promovimin e Akademisë së Rinjve, si organizim i ri shkencor në Shqipëri. Sekretari Shkencor i ASH-së, Vasil S.Tole, e cilësoi atë një ngjarje shkencore e kulturore. "E përqendruar në problematikën bashkëkohore për metodologjitë e kërkimit shkencor, kjo konferencë provon para së gjithash se Akademia e Rinjve nuk është një ide e bukur, apo një zgjatim i inkurajimeve europiane për afrimin e organizuar të brezit të reja të studiuesve, por një nismë që po funksionon dhe po i jep gjallëri edhe vetë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë".

Tole vlerësoi faktin që të rinjtë iu bashkuan akademizimit shqiptar në një moment jo aq inkurajues, për shkak të problemeve të njohura për kuptimet shpesh kontroverze rreth rolit të Akademisë së Shkencave sot. "Dhe kjo për ne është akt intelektual dhe moral. Mendimi ynë është se themelimi i Akademisë së Rinjve, themelimi i çmimeve kombëtare vjetore akademike, fillimi i punës për një hapje të gjërë ndaj publikut me botimin online të bibliografive shkencore, janë shprehje e një mendimi reformues brenda Akademisë sonë të përbashkët, e cila është në një proces reformimi në bashkëpunim me qeverinë dhe institucionet e vendit", tha sekretari shkencor. Me pritshmërinë që konferenca të ndikojë për mirë edhe në metodologjitë e kërkimit shkencor të brezave paraprirës, Tole ftoi senatet e universiteteve që të propozojnë kandidatë poten-

Ministria Nikolla përcjell mbështetjen e Ramës për brezin e ri

cialë për të qenë anëtarë të Akademisë së Rinjve. Në konferencë dje ishte edhe dr. Connie Nshemereiuve, përfaqësuese e Akademisë Botërore të Rinjve (Global Youth Academy-GYA). Ajo tha se, "përfitimet nga Akademia e Rinjve janë disa, pasi bëhet pjesë e shkëmbimit të ideve midis shkencëtarëve, bashkëpunon me ta për projekte të ndryshme". Bashkëkryetari i Akademisë së Shkencëtarëve të Rinj, Andi Rëmbeci, tha dje se kjo nismë, "një pjesë e kërkimeve ende realizohen me metoda dhe qasje interpretive tradicionale, edhe pse prirja mbizotëruese është 'reformimi' metodologjik". Sipas Rëmbecit, "vërshimi" i lirë i metodave kërkon më së pari edhe një diskutim në lidhje me to, për të qartësuar, përzgjedhur e braktisur metoda të caktuara, që nuk i përgjigjen realitetit të zhvillimit në Shqipëri. Përmes prurjeve shkencore, propozimeve dhe diskutimeve, konferenca synon të çojë përparim debatin shkencor për një çështje kaq gjithëpërfshirëse dhe aktuale për studimin shkencor.

E ARDHMJEA E SHKENCËS, MUZIKA, HISTORIA E MË TEJ

jashtë. Ardian Muhaj (Institut i Historisë) tha se historiografia shqiptare e dy dekadave të para të shek. XXI duhet kuptuar në kuadrin e përgjithshëm të shoqërisë në tërësi, e cila përballlet me problemet e një tranzicioni të zgjatur. Për të, tukurja e burimeve ekonomike dhe njëzore në komunitetin e historianëve ka sjellë një konservatorizëm të dukshëm në tërësinë metodologjike, që njëkohësisht i përshtrat trendit të përgjithshëm të inercisë shoqërore.

Andi Rëmbeci dhe Sokol Çunga për temën "Studimet në fushën e paleografisë bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri: vlerësime për të shkuarën dhe të tashmen, perspektivat dhe sfidat e së ardhmes" u morën me fondin e kodikëve. Sipas tyre, një



Cilët janë 16 emrat e së ardhmes së shkencës në Shqipëri



Në foto: Vaso Tole me dr. Connie Nshemereiuve, përfaqësuese e Akademisë Botërore të Rinjve (Global Youth Academy-GYA)

Akademia e Rinjve mbajti dje konferencën e saj të parë. Secili anëtar, mbajti një kumtesë mbi fushën e vet studimore, që nga biokimia e deri te albanologjia.

Edelajda Cepa ("Aleksandër Xhuvani") duke kumtuar trajtesën me temë: "Metoda të kërkimit shkencor në filologji. Lef Nosi si studiu dhe objekt studimi", tha se filologjia shqiptare dhe metodat e kërkimit shkencor në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore iu asen totalisht shkollës së Lindjes, ndikuar dhe prej kushteve social-kulturore e ideologjike. Metoda ishte krejt e kontrolluar nga dialektika e shkencës, pra si të ishte objekti, do të ishte metoda. Objekti përcaktonte metodat, duke i vënë ato "në shërbim" të tij, madje edhe mënyra e përdorimit të këtyre metodave shpesh dilte jashtë etikës së kërkimit shkencor, pasi mjaft materiale burimore ishin të koduara dhe krijuara dhe referimi ishte krejt hermetik, apo mungonte fare.

Mikaela Minga (Institut i Antropologjisë Kulturore) me punimin me temë "Etnomuzikologjia dhe kënga urbane në Shqipëri" vuri në dukje se dukuritë muzikore urbane kanë zënë një vend të reduktuar në traditën e stu-

nga çështjet që nuk është prekur në një studim të veçantë është historia e këtyre dorëshkrimeve, si dolën nga dora e përdoruesve të tyre, deri tek strehimi i tyre i sotëm në raftet e arkivave. Gjurmimi i tyre në kohë nëpër shekuj nuk është një detyrë e lehtë, për shkak të mungesës së informacionit. Megjithatë, një përpjekje në këtë fushë mund të bëhet.

Odetta Manahasa (Departamenti i Arkitekturës i Univ. "Epoka") kumtoi trajtesën me temë: "Dija nëpërmjet shikimit, shikimi nëpërmjet dijes". "Duke u ndalur në pikturën e Pablo Picasso-s 'Ma Jolie', e dhënë si një ushtrim fillestar në kompozimet dydimensionale studentëve të arkitekturës, ky punim përpiqet të japë një pikëpamje kritike mbi fuqinë e imazheve, të cilat janë mjet dijeje dhe që u japin liri hartuesve të mendimit", tha ajo.

Epidam Zeqo (kërkues i pavarur shkencor) tekta kumtoi për "Teorinë e zgjedhjes racionale - themeli qëllimshëm i gabuar i sjelljes i neoliberalizmit?" tha: "Kohët e fundit shkencëtarët socialë, si Thomas Piketty - i cili përdor metoda ndërdisiplinore - po dëshmojnë, se politikat neoliberale janë problematike dhe se ndihmojnë ata të paktët që zotërojnë kapitalin, jo shumicën rrugëtare".

Arta Xhika ("Aleksandër Xhuvani") duke folur për "Dy metoda në përfaqëse: nga shkolla e Romës në ato të Kalabrisë dhe Palermos", tha se Shkolla filologjike e Giuseppe Gradilone-s, që ka bartur peshën më të madhe në tejkalimin e shkollës kulturologjike të Koliqit, vjen në letrat shqipe si forma më e mirëkonturuar e filologjizimit klasik. Nga ana tjetër, me ndërmjetësinë e Solanos dhe të Pipës, shkolla filologjike e arbëreshëve të Jugut, sidomos Altmarit dhe Mandalasë, propozoi një filologjizëm modern, në përputhje me natyrën e traditës letrare shqiptare, të lindur drejtpërdrejt nga mekanizmi i gjallë i gjuhës popullore.

Eris Rusi (Univ. "Fan S. Noli") duke kumtuar për "Kompetencat letrare në letërsinë fantastike shqipe të shek. XX", synoi të eksploronte dimensionet e fantastikës në letërsinë shqipe, duke bërë një pasqyrë të përgjithshme të perspektivave të prozës fantastike dhe kuptimeve të shumta të saj në këtë literaturë.



Në foto: Lindita Nikolla dje në Akademinë e Shkencave

Ministri grek flet për takimin me Bushatin në Kretë: Të zgjidhim problemet e së kaluarës

Negociatat me Bushatin, Kotzias: Jemi drejt zgjidhjeve dypalëshe

"Tirana ka ndryshuar kurs, punojmë për të tashmen"

Ministri grek, Nikos Kotzias deklaroi dje për mediat greke se duhet të zgjidhen problemet e së kaluarës me Shqipërinë dhe të punohet për të tashmen. I pyetur nëse ka ndonjë shenjë ndryshimi në qëndrimin e qeverisë "Rama" kundrejt Athinës, Kotzias theksoi se në Tiranë është bërë i kuptueshëm fakti që rruga evropiane e vendit është më e rëndësishme se disa çështje të tjera.

Pas takimit të gjatë me homologun shqiptar në Kretë, jemi optimist për një zgjidhje-paketë të çështjeve dypalëshe të mbetura?

Përmas historisë së përbashkët të dy popujve tanë janë formuar varësi të shumta e të ndërthurura, vija përplasëse, mundësi miqësish. Kemi për detyrë të zgjidhim problemet e së kaluarës, të punojmë për të tashmen më të mirë të mundshme dhe të sigurojmë një axhendë pozitive bashkëpunimi për të ardhmen. Përsa u përket problemeve dhe mundësive të aksionit të përbashkët, të tjera kanë interes më të lartë për palën shqiptare, të tjera për atë greke. Thajtimi i përbashkët i tyre përbën atë që në teorinë e negociatave quhet "zgjidhja-paketë", pasi në bazë të kësaj zgjidhjeje merret parasysh asimetria ekz-

istente e çdo rasti në interesat për tematika të ndryshme. Mendoj se jemi në rrugën e duhur për t'u drejtuar në një marrëveshje, që do të jetë pozitive për të dyja palët.

Opozita greke kërkoi të përshkruant negociatat me Ditmir Bushatin para se të fillonte takimi. Si e komentoni?

E konsideroj të paktën të mefshtë faktin që disa politikanë të opozitës kërkoi para se të nisim një negociatë të flasim në publik, po ashtu në publik për propozimet dhe të rrëfejmi taktikën që do të ndjekim. Të njëjtën gjë bënë edhe në rastin e FYROM apo të Qipros. Ndoshta u mungon eksperiencia e negociatave reale dhe kërkoi një shpalosim tek të tretë strategjinë tonë negociatave para kohe.

Ekzistojnë shenja ndry-



Ministri grek, Nikos Kotzias me ministrin e Jashtëm Ditmir Bushati

shimi në qëndrimin e qeverisë "Rama" ndaj Athinës zyrtare?

Kam vënë re se është eurë e qartë që perspektiva evropiane e vendit është më e rëndësishme sesa çështjet e tjera. Lexova edhe tekstet e fundit të tij, që flasin për zhvillimin e një marrëdhënie

atëhershme. Në vazhdim e paraqiti sikur të ishte bërë pardje dhe më pas kanibalizonin Shqipërinë dhe mua për negociatat e fundit. Këto janë taktika të mefshta, që nuk ndihmojnë për asgjë. Përveç rastit kur duan politikë të jashtme të ngathtë dhe probleme të zvarritura pafund. Personalisht refuzoj të bëj politikë të jashtme me sytë drejtuar mikropolitikës.

Greqia e mbështet perspektivën europiane të Turqisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor?

Nëse dikush përfiton nga integrimi i këtyre vendeve në BE, nga demokratizimi dhe europianizimi i tyre, ky vend është Greqia. Por duhet që këto vende të plotësojnë kushtet që janë vendosur për të kaluar në këtë fazë. Kushte që kanë interes të drejtpërdrejtë për Greqinë dhe shpeshherë janë dhe rezultat

i propozimeve tona.

BE sot, në mes të krizës, ka mundësinë dhe vullnetin të mbështesë anëtarësimin e plotë në vendeve të reja?

E ka këtë mundësi, por duhet të bëhet më esencial, më demokratik dhe me më shumë vizione për drejtësi sociale, të thellojë procedurat për përfundimin e anëtarësimit. Të marrë vendimin se të gjitha vendet, të vjetra apo të reja, të vogla apo të mëdha do të jenë të barabarta mes tyre dhe se qytetari i cillitdo nga këto vende, shoqëria dhe grupet shoqërore me probleme madhore sot duhet të jenë zemra e një BE-je demokratike, të sensibilizuar dhe të drejtë. Kështu, BE e ka mundësinë, por rruga e realizimit të këtyre mundësive është e vështirë, e gjatë dhe plot beteja sociale.



REPUBLIKA E SHQIPERISE INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelitit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjykatëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organike dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelitit".

I - Shpall vendet vakante për pozicionet:

1. Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Mardhënieve me Median dhe Publikun
Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

2. Drejtor në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

3. Specialist Sekretarie Gjyqësore

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

4. Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Degën Gjyqësor - Letërsi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

5. Përkthyes

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip.
 - Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
 - Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombetare.

6. Koordinator për mediat dhe mardhënie me jashtë

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit të arsimit të Lartë në Drejtësi/ Gazetari/Gjuhë-Letërsi etj.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e mardhënieve me median/ mardhënie me jashtë.

7. Specialist për prirjen me popullin

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë në Drejtësi.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

II - Rishpall vendet vakante për pozicionet:

8. Specialist Financë/Buxhet

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
 - Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

9. Specialist i Burimeve Njerëzore

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

10. Specialist IT

- Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji informacioni etj.
 - Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
 - Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
 - Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
 - Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve të Eordpress, Drupal, Joomla etj).
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

11. Specialist Protokol/Arkive

- Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:
- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
 - Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
 - Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTET TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me Certifikatë Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 15 Dhjetor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomën që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislatcionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Epuror Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

NR. DOK. / EMER / MBIEMER	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE PARE	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE DYTE	KOPIE TE LETR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VBEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILIAR
10424	HAKI VERDOVA	HAJIM VERDOVA				
10425	GYSH ISLAMAJ	SALO ISLAMAJ				
10426	REIS XHEMOLLARI	ASLLAN				
10427	RASIM BOKSI					
10428	SHERIF CELA	FAHRI HASAN SHERIF CELA				
10429		GURRIJE HASAN RIZITI HASAN RIZITI				
10430		RUZHDU E LIBRI HASAN LUNAN BESNIK LINDITA				
10431		REGOR HALIT FATIME MEHDI HARIBE HARIBE HATIZE YMER BEPHE				
10432	ELIA GJYLAM ETI	DHIMITRI AQ ANASTAS				
10433	Ded Marku	502 LLESH				
10434		Gjelle Zef				
10435		Gjok Ndrej				

NR. DOK. / EMER / MBIEMER	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE PARE	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE DYTE	KOPIE TE LETR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VBEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILIAR
12620	Nesim Vioni	509 RASIM RASIM				
12621		Adje Rasim				
12622	ZISO KOSTA	Eshref RASIM				
12623	MHILL MBILLAJ	DAVE MHILL				
12624		KOLE BARBULL PIETER MARE PASHKE				
12625	KOCO PAPA	ANDREA PAPA				
12626		KRISTINA ANDREA				
12627		ANDREA VANGHEL THEOFAN				
12628	DEDE MIRASHI (RIPAJ)	MIRASHI DEDE				
12629		GHON NDREJE				
12630	VASIL DEDE	PANDO DEDE				
12631		EVANTH A				
12632		THEOBARDI KRISTAN				

TRASHEGIMTARET E KESTIT TE DYTE

NR. DOK. / EMER / MBIEMER	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE PARE	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE DYTE	KOPIE TE LETR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VBEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILIAR
19206	Jani Qehaja	Theodhori Stefan Qehaja				
19226	Shabani Lajthiza	Shkurte Ali Brecani				
19204	Gjon Marku	Pieter Ndue Marku				
19241	Hyani Gjoka					
19242		Vasha Rustem Gjoka				
19243		Fatma Hyani Gjoka				
19244		Sazmir Hyani Gjoka				
19245		Lijana Hyani Leka (Gjoka)				
19246		Arben Hyani Gjoka				
19247		Mimosa Hyani Bred Gjoka				
19248		Aida Hyani Krumarku(Gjoka)				
19249		Agjona Hyani Gjoka				
19685	Musa Qordja	Sabirte Mustafa Qordja				
19686		Hanan Musa Qordja				
19687		Daut Musa Qordja				
19688		Kolbe Musa Qordja				
19689		Shkurte Musa Bili (Qordja)				
19028	Din Mehmetaj	Gjylshah Shem Muja (Mehmetaj)				
19029		Dervish Din Mehmetaj				
19030		Haribe Din Mehmetaj				
19031		Vander Din Mehmetaj				
19032		Selver Din Mehmetaj				
19033		Mimosa Din Bucepagj (Mehmetaj)				
19034		Zef Din Mehmetaj				
10676	Ali Hooha	Sarbene Fetah Hooha				
10677		Shine Ali Palushi (Hooha)				
10678		Adem Ali Hooha				
10679		Hadis (Adem) Ali Hooha				
10680		Nesibe Ali Nema (Hooha)				
10681		Fatmir Ali Hooha				
4718	Shahin Emiri	Rasime Reshep Emiri				
4719		Mihajir Shahin Emiri				
4720		Ena Shahin Emiri				
4721		Enxhep Mehmetaj				
20248	Bejko Shkreta	Dyzo Lime Kalemi				
19611	Gjon Dodani	Dile Koli Dodani				
19612		Prend Gjon Dodani				
19613		Prend Dodani				
19614		Prend Kabashi (Dodani)				

NR. DOK. / EMER / MBIEMER	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE PARE	EMRAT E PERFTUESVE TE RADHES SE DYTE	KOPIE TE LETR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VBEKJE	CERTIFIKATE TRUNGUT FAMILIAR
19117	Sami Korbi	Shaqir Vehap Korbi				
19118		Lumburi Shaqir Korbi				
19119		Hamine Shaqir Korbi				
19120		Rahime Shaqir Korbi				
19121		Zahide Shaqir Korbi				
19122		Samir Shaqir Korbi				
19123		Vehap Shaqir Korbi				
19124		Shpresa Shaqir Korbi				
19125		Refik Shaqir Korbi				
19126		Agdon Shaqir Korbi				
19127		Lindita Shaqir Korbi				
20023	Demir Lusha	Ramadan Demir Lusha				
20024		Bullurije Ramadan Spata (Lusha)				
20025		Kujtim Ramadan Lusha				
20026		Arif Ramadan Lusha				
20027		Demir Ramadan Lusha				
20028		Hesib Ramadan Lusha				
20029		Kafije Ramadan Kastrori (Lusha)				
20718	Stavo Kononi	Adhina Besa Kononi				
20719		Dhimitër Stavro Kononi				
20720		Stefan Stavro Kononi				
20140	Khezhar Rehmati	Beharije Khezhar Bashja				
20141		Mirza Khezhar Mujë				
20142		Beqar Khezhar Rehmati				
20143		Adnan Khezhar Rehmati				
15693	Musi Berisha	Shkurte Musi Berisha				
15694		Spas Musi Berisha				
15695		Nurije Sulajman Berisha				
1994	Gjon Buna	Simon Gjon Buna				
18818	Mark Ujka	Kole Mark Ujka				
18819		Shaqir Mark Ujka				
18820		Pieter Mark Matusha (Ujka)				
17638	Mizafer (Xhaferri)	Nesir Mizafer (Xhaferri)				
17639		Liri Mizafer Xhaferri (Xhaferri)				
17640		Ena Mizafer Xhaferri (Xhaferri)				
17641		Elxhep Mizafer Xhaferri (Xhaferri)				
17642		Bukurishe Mizafer Xhaferri (Xhaferri)				
17643		Aleksander Mizafer Xhaferri (Xhaferri)				
17644		Rezil Mizafer Xhaferri (Xhaferri)				
12798	Gjergj Dodaj	Ndue Gjergj Dodaj				
12799		Tane Gjergj Suti (Dodaj)				
15659	Mark Nikollë	Ndue Mark Nikollë				
15660		Sofije Vasilika Mark Nikollë				

Table with columns for name, gender, and various status indicators. Includes entries like 14946 DEJBR QISJA, 14947 DEJBR QISJA, etc.

Table with columns for name, gender, and various status indicators. Includes entries like 14954 GJON CARA, 14955 OLLGA PROGR, etc.

Table with columns for name, gender, and various status indicators. Includes entries like 14956 SULO DAKU, 14957 SULO DAKU, etc.

Table with columns for name, gender, and various status indicators. Includes entries like 14958 SULO DAKU, 14959 SULO DAKU, etc.

Table with columns for name, gender, and various status indicators. Includes entries like 14960 ARTUR DAKA, 14961 ZABIT BUFAJ, etc.

Table with columns for name, gender, and various status indicators. Includes entries like 14962 GJERG MARRU(GURAJ), 14963 FITIM GJURA, etc.

Table with columns: NR. NR., MBILLI, BEQARAJ, and various names. Includes entries for families like BEQARAJ, THOMA, ALI, and others.

Table with columns: NR. NR., FOH, NNI, and various names. Includes entries for families like HANAN, HANAN, HANAN, and others.

Opinion i Ditës

Shqipëria 2018, drejt një hapi të madh

Nga Ditmir Bushati *

(Vijon nga faqja e parë)

... Perëndimor dhe BE-së gjatë dy viteve të fundit, është e qartë se ky do të jetë një vit vendimtar për shpresat e Ballkanit Perëndimor për anëtarësim.

Më 2017, Shqipëria ka përshpetuar ndjeshëm ecurinë e saj. Kuvendi i Shqipërisë miratoi unanimisht një reformë të pashembullit të sistemit të drejtësisë, e cila ndryshoi rrënjësisht Kushtetutën tonë, duke krijuar një procedurë të re për rivlerësimin tërësor të gjyqësorit.

Pavarësisht pengesave dhe rezistencës së shfaqur, zbatimi i reformës në gjyqësor ka filluar duke krijuar komisione të vetingut, me ndihmën dhe mbështetjen e BE-së dhe SHBA-ve. Unë besoj se ajo që kemi arritur deri më tani përbën një bazë të shëndoshë për punën e mëtejshme, në kuadër të negociatave për anëtarësim lidhur me kapitujt 23 dhe 24 me Bashkimin Evropian. Jemi gati të përparojmë në rrugën e integritetit të Shqipërisë në BE. Reforma e gjyqësorit do të ketë gjithashtu një ndikim të drejtpërdrejtë në arritjet tona në fusha të tjera, siç është lufta kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar.

Reforma të tilla të thella shpesh hasin rezistencë dhe mosbesim. Pavarësisht gjithçkaje, ne e dimë që nuk ka alternativë tjetër. Shqipëria ka treguar vazhdimisht qartësi dhe qëndrueshmëri strategjike në orientimin e saj euroatlantik. Humbja e qasjes strategjike do të ishte një gabim fatal dhe kurrsesi nuk mund të konsiderohet opsion.


Strategjia Globale e BE-së, e botuar një vit më parë, e konsideron besueshmërinë e procesit të zgjerimit si një investim strategjik për sigurinë dhe prosperitetin e Evropës. Një gjë e tillë ka kontribuar deri më tani për paqen, stabilitetin dhe progresin në Ballkanin Perëndimor.

Nuk është idealizmi që i bën shqiptarët entuziastë për BE-në, por realizmi. Njohja e interesave të përbashkëta, perspektiva e prosperitetit të qëndrueshëm, paqes, sigurisë dhe qeverisjes së mirë.

Bashkëpunimi më i ngushtë mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor përbën garanci për sigurinë dhe paqen në këtë kënd të Evropës.

Dëshirojmë që BE të njohë potencialin tonë si një partner, duke hapur negociatat e anëtarësimit gjatë pranverës së vitit 2018.

Jemi të vetëdijshëm se hapja e negociatave është vetëm fillimi i një procesi të gjatë dhe sfidues të të mësuarit. Ne e dimë shumë mirë se do të duhet kohë. Dhe duam ta përdorim këtë kohë për ta transformuar në të gjitha drejtimet vendin tonë dhe për t'i sjellë qytetarët tanë më pranë Evropës. Nuk do të jetë e lehtë të bindim të rinjtë tanë për përfitimet e integritetit në BE. Pasi realisht do të duhen më shumë se pesë dekada për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të arrijnë standardin e jetesës së Evropës Perëndimore. Kështu, është i kuptueshëm padurimi i rinisë sonë.



Por, lajme të mira po vijnë nga Brukseli dhe nga vetë rajoni, të cilat na bëjnë optimistë. Gjatë katër viteve të fundit, të nxitur nga energjitë e investuara në Procesin e Berlinit, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë punuar për të eliminuar pengesat ndaj tregtisë së lirë, duke nxitur ekonomitë ndërkufitare.

Në korrik të këtij viti, ne ramë dakord në Trieste për të krijuar një Zonë Ekonomike Rajonale. Presim që kjo të nxisë më tej zhvillimin e tregtisë, të çlirojë energjitë e ndrydhura dhe të rrisë përfitimet për ekonomitë tona.

Mirëpresim faktin që zgjerimi i Ballkanit Perëndimor është një prioritet kyç i Presidencës bullgare dhe besojmë se 6 muajt e ardhshëm do të jenë me rëndësi vendimtare për ne. Komisioni Evropian do të paraqesë Strategjinë e Zgjerimit në

shkurt të 2018-ës. Presim një dokument me vizion të qartë dhe që Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht Shqipëria të jenë pjesë e këtij vizioni. Gjithashtu, shpresojmë të marrim një rekomandim të pakushtëzuar për hapjen e negociatave në raportin e Komisionit Evropian në prill dhe që Këshilli Evropian të marrë një vendim për të hapur negociatat. Mosarritja e këtij objekti do të ishte një mundësi e humbur.

Disa muaj më parë, presidenti Juncker, në fjalimin e tij vjetor mbi "gjendjen e Bashkimit Evropian" deklaroi se është e domosdoshme një perspektivë e besueshme e zgjerimit për Ballkanin Perëndimor, me qëllim që të sigurojë në shumë stabilitet në këtë zonë. Presidenti francez, Macron i bëri jehonë të njëjtës pikëpamje. Ne e mirëpresim këtë

qasje, sepse jemi të bindur pasi besojmë se rigjallërimi i procesit të zgjerimit është katalizator për zhvillim. E në të njëjtën kohë, kundërvënien e fuqishme ndaj narrativës së shpërbërjes, e nxitur nga idetë populiste dhe propaganda e palëve të treta në shtete antievropiane.

Kemi qenë gjithmonë të mendimit se secili vend duhet të përparojë me shpejtësinë e vet në rrugën e tij drejt anëtarësimit në BE, në përpunje me kapacitetin e vet, ritmin e reformave dhe qëndrueshmërinë në përmbushjen e angazhimeve. Prandaj, u bëj thirrje partnerëve tanë evropianë të shohin progresin që ka bërë Shqipëria dhe të na japin një perspektivë të qartë dhe një udhërrëfyes drejt pranimit në BE.

*** Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë**

HOROSKOPI

DASHI

Në punë do t'ju duhet të përshpejtoni gjërat, sidomos nëse fitimi vjen menjëherë. Bëni kujdes me shpenzimet, pasi do të keni dëshirë të kryeni shumë blerje sot. Megjithatë, nëse vendosi të bëni blerje të mëdha tregohuni të zgjuar në zgjedhje.

DEMI

Do të jetë një ditë emocionuese dhe me shumë zhvillime. Yjet ju shtynë që të dilni, të takoni njerëz të rinj, të argëtoheni dhe të zbuloni botën e kulturës. Është ditë ideale për të organizuar një udhëtim, qoftë për punë, qoftë për kënaqësi.

BINJAKET

Më mirë t'i lëni gjërat ashtu siç janë, sot që planetet ju provokojnë hapur, duke bërë që të humbini kohë të çmuar. Është e vërtetë që jeni jashtëzakonisht të duruar, por çdo gjë ka një kufi.

GAFORJA

Nuk jeni nga ata që lini t'ju ikë një mundësi për t'u dëfryer, sidomos kur një Hënë e zjarrtë dhe e hareshme ju thërrit të argëtoheni. Kështu, pavarësisht nga barra e angazhimeve të ditës që keni, do të bëni gjithçka për të pranuar ftesën e saj.

LUANI

Kjo është dita ideale për të lënë mënjanë gjërat që nuk shkojnë në fushën profesionale dhe të përgatiteni për një ndryshim të qenësishëm të strategjisë ose objektivave. Ndërkohë, shmangni të menduarit e gjërave shumë të mëdha dhe kushtojni rëndësi burimet që keni në dispozicion.

VIrgjeresha

Ditë për t'u mbajtur mend, ku të gjithë do të jenë kundër njëri-tjetrit: ju, partneri, fëmijët, kunetërit dhe prindërit. Dhe kështu do të ketë një mori hatërbetëjesh dhe bashkëbisedime ironike. Edhe një marrëveshje ndër akcionarë mund të prishet. Ju shkatëroni polemika, ndërsa të tjerët reagojnë keq.

PESHORJA

Dozat e vogla të dembelizmit janë një "luks i nevojshëm", por nëse e teproni mund të humbni të gjithë ditën dhe mund të pendoheni shumë të nesërmen. Plutoni, i cili ju mbështet prej shumë vitesh, do të vazhdojë të jetë një mik i vetëm dhe i vërtetë. Ndërkaq, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për yjet e tjera.

AKREPI

Ditë me fat. Të ndihmuar nga bashkëpunimi i Hënës, Venusit, Marsit dhe Uranit jeni në një pozicion mbarësie. Do të ketë një shans edhe për ata që pëlqejnë vetminë. Ndoshta nuk do të gjeni shpirtin binjak, por dikë që është pak a shumë ashtu.

SHIGJETARI

Në punë jeni të përkushtuar, por vullneti i personit që keni në krah ndërfryn për të ndryshuar gjërat, duke bërë që t'ju ndryshojë programin. Do të keni edhe zënka në çift, me grindje të lodhshme për të përcaktuar se kush do të imponojë vullnetin e vet.

BRICJAPI

Me mbështetjen e shumë planeve në harmoni, dita fillon me mbarësi. Të arrini objektivat do të jetë një lojë fëmijësh. Një takim i papritur me një mik të vjetër do të bëjë që të ndryshoni planet për mbërmen.

UJORI

Sot humori i juaj është i lidhur me melankolinë e ditës, me shumë plane të heshtur në Shtëpinë e dyndëbjetë. Do të keni apati dhe mungesë motivimi për të punuar. Për t'ju ngushëlluar, do të keni shumë miq të sinqertë që ju mbështesin.

PESHQIT

Lërimi butësinë që të rrjedhë lirisht. Do të shërbejë për të gëmtuar një lidhje të konsoliduar ose të shkrijë ndrojtjen në një marrëdhënie të porsalindur. Në punë do t'ju duhet të pranoni disa kompromise, solidariteti është i barasvlershëm me suksesin e ndërmarrjeve.

Opinion *i* Ditës

Nga Arian Galdini

Për flamurin e një kombi dhe dy qeveritë e tij!

(Vijon nga faqja e parë)

... bën që e gjithë paradigma e aspiratave tona kombëtare, por edhe e qeverisjes së drejtë, demokratike dhe në liri e me dinjitet të plotë njerëzor të shqiptarëve, të ndërtohet mbi themele të gabuara.

A jam unë nacionalist, në kuptimin e një idealisti dhe aktivisti që do kombin e tij përmbi gjithçka e që urren a përçmon gjithkënd e gjithçka tjetër që është apo vjen nga kombe të tjera, sidomos ato fqinje?

Jo! Jo dhe vetëm jo!

Jam kombëtarist që e dua kombin tim mbi gjithçka timen. Nuk urrej e as përçmoj askënd për shkak të dashurisë për kombin tim. Madje, parimin e dinjitetit njerëzor e besoj të plotë për çdo qenie njerëzore në këtë planet.

Jam kombëtarist i rritur, mëkuar dhe ndërtuar vetëm nga arsytet e dashurisë, identitetit të qartë dhe motivimet e mbara të lartësimit të të drejtave dhe dinjitetit njerëzor.

Nuk ka në botë person, fuqi a interes që mund të ma lëkundë mua këtë ekzistencë si kombëtarist nga dashuria për kombin tim dhe njeriun si qenie.

Ndaj t'i rikthehem arsyetimit parësor, duke mos lënë qime personale në duart e askujt që do të kërkojë ta rrjepë këtë reflektim publik.

Qeveria e Shqipërisë është pa diskutim qeveria më përfaqësuese e kombit shqiptar. Kjo nuk vjen për meritë të vetë qeverisë, por si rrjedhojë logjike e fakteve historike dhe gjeostrategjike.

Qeveria e Kosovës është qeveri me kryeministër e me shumicë dërrmuese e shqiptarëve, por i duhet të merret jo vetëm me punët e shqiptarëve, përpos atyre të pakicave që jetojnë atje.

Qeveria e Maqedonisë është qeveri me kryeministër sllavo-maqedonas, shumicë sllavo-maqedonase, e megjithatë ka edhe përbërje të ndjeshme të shqiptarëve. Kjo qeveri ka punë me sllavo-maqedonasit dhe shqiptarët kushtimisht, e nuk mund të anashkalojë pakicat e tjera.

Qeveria e Malit të Zi ka kryeministër dhe shumicë dërrmuese malazeze, ama e ka edhe një ministër shqiptar brenda saj e duhet të kujdeset normalisht edhe për rreth 7% të popullsisë së Malit të Zi, që është shqiptare.

Ndërkohë që qeveria e Greqisë ka veçantësinë që edhe pse nuk ka asnjë shqiptar, së paku të njohur formalisht si të tillë, ka shumë punë që e lidhin me shqiptarët që jetojnë atje si arvanitas, të padeklaruar, çamë ortodoksë, emigrantë, si edhe me pronat e pasuritë e shqiptarëve, përfshirë këtu edhe çështjen çame.

Ky parashtrim na ndihmon të kuptojmë se asnjë deklaratë e shitur si patriotike për kinse 1 komb me 2 qeveri nuk është e tillë, pra nuk është në të vërtetë patriotike. Është aktoreske dhe patetike, ama kurrsesi patriotike.

Që 2 qeveri të bashkojnë një komb u duhet të jenë përfaqësuese tërësore të këtij kombi.

Jemi të gjithë të qartë se qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës përfaqësojnë shumicën absolute të shqiptarëve e për rrjedhojë kanë edhe detyrimin politik dhe institucional që të kujdesen e marrin vendime të forta për të gjithë shqiptarët kudo që ata ndodhen.

Që ta bëjnë këtë, u duhet të dyja qeverive që ndërsa punojnë e bashkërendohen për marrëveshjet dytësore, me karakter ndërsh-tetëror, të nisin projektimin e politikave të përbashkëta të buruara e

ndërlidhura me aspiratat tona kombëtare.

Janë shumë të domosdoshme edhe marrëveshjet ndërsh-tetërore, nëse zhvillohen dhe zbatohen përpikmërisht në kohën e kornizat sipas nënshkrimeve.

Sidoqoftë, që të mos rrezikojmë rënien në përdorim simbolikash dhe aktesh politike me sfond patriotik për arsye të politikave dhe marketingut ditor, ka rëndësi madhore të kërkohen dhe bashkërendohen projekte thelbësore me burim dhe qëllimësi, aspiratat tona kombëtare.

E di që do të më thonë se do

bashkohemi kur të jemi pjesë e familjes europiane si anëtarë të BE me të drejta të plota.

Por, nuk mund të rri pa u përgjigjur atyre që thonë e mendojnë kësaj: Po si mund të integrohemi pa u bashkuar? E nëse projekti i integritit evropian bëhet i gjatë, plot kthesa e të paditura, si mund të bashkohemi pa u integruar? A kemi ne si shqiptarët një projekt tonin, një axhendë tonë në njëfrekuencim me partnerët dhe aleatët tanë strategjikë SHBA, UK dhe BE por edhe të përgatitur për çdo variabël të panjohur gjeostrategjik?





BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA



ALBANIA THASHETHEME MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me

KALENDARI



FSHF ka caktuar datat dhe oraret për ndeshjet e javës së 14 të Kategorisë Superiore, e cila do të ndahet në dy ditë, të shtunën dhe të dielën, duke mos pasur më zhvendosje të planifikuara për të hënën, siç ka ndodhur në javët e fundit. Ndeshja që hap javën do të jetë ajo e së shtunës në Kukës, ku veriëndorët presin Lushnjën e fundit të

Java e 14 e Kategorisë Superiore luhet në 2 ditë

tabelës. Ky do të jetë rasti më i mirë për të treguar se kampionët në fuqi nuk po kalojnë krizë dhe se mund të rikthehen në shinat e duhura. Më pas, e ka radhën due-li delikat mes Flamurtarit

dhe Vilaznisë, që mund të tregojë më mirë se si do të vijojnë sezonin dy ekipet. Të dielën luhet dy ndeshje në orën 14:00, me Kamzën që pret Luftëtarin dhe Laçin që luan pa tifozë përballë

Skënderbeut. Këta të fundit, edhe pse luajnë të enjten në Zvicër, nuk kanë bërë kërkesë që të shtyhet ndeshja e tyre me kurbinasit, të bindur se mund ta kalojnë këtë pengesë, pavarësisht lodhjeve të udhëimit evropian. Dueli që mbyll këtë javë është ai i së dielës pasdite, kur Partizani pret Teutën. Dy skuadrat kanë dhuruar përballje mjaft të

SUPERLIGA	
JAVA E 14	
TË SHTUNËN	
Kukësi-Lushnja	14:00
Flamurtari-Vllaznia	17:00
TË DIELËN	
Laçi-Skënderbeu	14:00
Kamza-Luftëtari	14:00
Partizani-Teuta	17:00

luftuara në të kaluarën dhe ashtu pritet të jetë edhe e kësaj jave në "Selman Stërmasi".

Duro pranon barazimin, ndërsa deklaroi se Bushiç luajti, ndonëse nuk është në 100 të formës



Jeton Selimi

Bregu prish festën vlonjate, mbyllet 0-0 në Gjirokastrë

Trajneri Hasan Lika pret përforcime në janar

Një vlonjat i prish festën e fitimit të Flamurtarit. Në javën e 14 të Kategorisë Superiore, në ndeshjen e 14 të Kategorisë Superiore, u mohoi tri pikët kuqezinjve në transfertën gjirokastrite. Në minutën e 80-të ishte pikërisht fantazisti shtatshkurtër, i cili iu vodh mjaft mirë mbulimit të mbrojtjes vlonjate, duke barazuar shifrat në 1-1. Një barazim që nuk i shërben asnjë skuadre, por nga mënyra se si erdhi, nuk është për t'u hedhur poshtë, të paktën nga gjirokastritët. Vlonjatët kaluan të parët në avantazh me një aksion model të finalizuar nga Xhufo në minutën e 25-të. Të dyja skuadrat zhvilluan një futboll të hapur, krijuan disa raste për shënim, por pa mundur të dalin me pikë të plota. Luftëtari vijon të lundrojë në ujëra të turbullta, teksa pozicionohet në vendin e parafundit në kuotën e 10-të pikëve, ndërsa Flamurtari në vendin e 4-të me 22 pikë.

LIKA
Trajneri Hasan Lika theksoi pas barazimit 1-1 me Flamurtarin se skuadra gabon në mënyrën si mbrohet dhe në pasimin final, por ka

falënderuar të tijtë për sakrificën, veçanërisht kapitenin Beqiri, Rocën dhe Aleksin, që luajtën të dëmtuar, ndërsa deklaroi se në janar, klubi gjirokastrit do të lëvizë patjetër në merkato. "Kemi probleme në aspektin mbrojtës si skuadër dhe si individë. Meritojmë nota pozitive, sepse nuk është e lehtë për të rikuperuar, kur e nis në disavantazh. Dua të falënderoj futbollistët që dhanë maksimumin, pa përjashtim. Veçanërisht Beqirin, i cili pësoi një dëmtim në nxehtë, por sakrifiko. Nuk ishte në 100%, por bëri sa mundi. Falënderoj edhe Rocën dhe Aleksin, që kanë pasur probleme gjatë javës në stërvitje. Një farë frike apo droje ka në skuadër, është normale për çdo ekip në këto pozita. Krijojmë shumë, por na mungon konkludimi.



Sot, më shumë se çdo herë tjetër, pasimi i fundit kishte probleme. Na duhet të përforcohemi, pasi me këtë kontingjent kemi probleme në këtë kampionat të gjatë. Besoj se do të përforcohemi, kështu kemi biseduar me presidentin".

DURO
Trajneri i Flamurtarit, Shpëtim Duro nuk e bën dramë barazimin ndaj Luftëtarit. Strategu i njohur ka vlerësuar kundërshtarët, teksa ka evidentuar se lojtarët e tij duhet ta kishin mbyllur ndeshjen gjatë

pjesës së dytë. "Flamurtari nuk ruan avantazhin? Me Laçin, arbitri na mohoi dy penallti. Me Kukësin dhe Skënderbeun barazimi ishte normal, ndërkohë që sot barazimi mund të cilësohet normal, sepse ata kanë 3-4 lojtarë në fazën sulmuese. Më vjen keq që nuk fituam, por në këtë situatë që ndodhet Luftëtari, rezultati është i pranishëm. Në pjesën e dytë administruam shumë mirë lojën, teksa kishim dhe shanse për të shënuar. Bushiç nuk ka qenë në 100 për qind, rrezikova shumë me të. Kur shpërdorun raste, edhe mund ta pësoh. Ndeshja e ardhshme në Vlorë? Ende nuk kam folur me Idrizin, por do të shohim gjatë javës se si do të vendosim sa i përket tifozerisë", u shpreh Duro për "SuperSport".

SFIDA NDAJ JANG BOJS

Referee	
Lee Evans (WAL)	Assistant referees
Philip Thomas (WAL)	
Ian Bird (WAL)	
Fourth official	
Daniel Beckett (WAL)	
Additional assistant referees	
Ryn Markham-Jones (WAL)	

Një uellsian gjykon të fundit të Skënderbeut në Europë

Teksa futemi në javën e fundit të ndeshjeve në Europë, përta i përket fazës së grupeve, janë zbardhur edhe emrat e arbitrave për këto takime. Për Skënderbeun, UEFA ka caktuar një arbitër nga Uellsia, që të vendosë drejtësi në sfidën ndaj Jang Bojs. Li Evans është 42-vjeçari, i cili që nga viti 2007 mban stemën e FIFA-s. Uellsiani ka gjykuar rreth 60 ndeshje ndërkombëtare, ndërsa ekipin e Jang Bojs, ai e ka gjykuar po vjet në fazën e grupeve. Ja dhe lista e plotë e gjyqtarëve për këtë takim.

Vëllai i kryeministrit synon post drejtues te Partizani

Nis kursi i "Drejtorit Sportiv", Olsi Rama merr leksione

Ka nisur dje në ambientet e Federatës Shqiptare të Futbollit kursi i "Drejtorit Sportiv", i cili do të zgjasë deri në datën 16 dhjetor. Edhe pse prezenca e drejtuesve që ishin të interesuar për të marrë këtë licencë ishte e vogël, ajo që ra më shumë në sy ishte prania e Olsi Ramës, vëllai i kryeministrit Edi Rama, i cili së fundmi ka marrë një post drejtues te klubi i Partizanit. Ky kurs do të drejtohet nga shefi i sektorit, Astrit Maçi. "Panorama Sport" mëson ekskluziv-



isht që në prezantimin e sotëm, Maçi u shpreh i pakënaqur për numrin e pakët të kursantëve. "Janë 66 klube dhe kemi kaq pak të interesuar për të marrë licencën e drejtorit sportiv.

Nuk do të lejohet asnjë individ të qëndrojë në pankinë ose në ambientet e brendshme të stadiumit në qoftë se nuk disponon këtë licencë", u shpreh shefi i sektorit.

Familja Mesi, sërish probleme

Vëllai i Leo Mesit, luftë të armatosur me bandat


Familja e Lionel Mesit nuk rri dot larg problemeve. Pas akuzave të vetë yllit të Barcelonës për evazion fiskal, kësaj radhe është vëllai i tij, ai që rrezikon të dënohet me burg. Matias Mesi është në spital momentalisht, pasi po kurohet për një brinjë të thyer dhe për shumë fraktura të tjera. 35-vjeçari ka pësuar një aksident me varkën e tij, e cila u gjet e gjakosur në brigjet e një lumi në Argjentinë. Brenda në varkë, policia kishte gjetur dhe një armë, e cila mbahej pa leje nga vëllai



i Mesit. Dënimi minimal që policia argjentinase jep për armëmbajtje pa leje është 4 vjet, por Matias mund të dënohet deri në 8 vjet, pasi policia dyshon për një përleshje të 35-vjeçarit me një

bandë kriminale të qytetit Rosario. Familja Mesi ka hedhur poshtë të gjitha akuzat e policisë dhe ka deklaruar që do hedhë në gjyq të gjithë ata që kanë trilluar një histori të tillë.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Me të nxjerrin një tapë.
4. Inicialet e Klee piktor.
6. Qiriaçi aktor.
9. Etikë pa kufij.
11. Merren për shembull.
14. Fund janari.
15. Janë edhe ata të skuadrës.
17. Otolani kompozitor.
18. Ushtrohej edhe nga bukanierët.
20. Në krye të sondazheve.
21. Janë të ndaluar në kthesë.
23. Ente Rajonale Civile.
24. Gjermania në tabela.
25. Mund të jetë unik.
27. Philippe që qe aktor.
29. Një pjesë e pelegrinazhit.
31. Gjysmë leader.
32. Maten pa zë.
33. Janë të përpjeta.

35. Qytet anglez.
36. Louis, poet surrealist.
38. Artet pa re.
39. Matet pa kufij.
40. Gruaja e Ben Hur.
42. Liam i Schindler's list.
45. Të parat në orkestër.
47. Makina Ibiza.
48. Renato, piktor i famshëm italian.
49. Mihali këngëtare lirike.

VERTIKAL

1. Mbyllin fushata.
2. Një pjesë e pikturave.
3. Janë njëvjeçarë.
4. Një ngjyhet në tavolocë.
5. Është katolik ai i papës.
6. Mbyllin portat.
7. Opera e Mascagni-t.
8. Tregohet duke bërë masakra.
10. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
11. Një gjuajtës francez.

12. Është porti i Durrësit.
13. Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
16. Pak pirografi.
19. Një pjesë e aerobisë.
21. U vodhi zjarrin perëndive.
22. Premtojnë të bëhen asa.
23. Mbeten në fund.
26. Rreth pa ekstreme.
28. Rendi pa zë.
29. Është veshje tahitianësh.
30. Tase e volejbollit.
32. Është shahu i fundit.
34. Kim... Stuart aktor.
35. Fritz regjisor.
37. Ai i shtatë është kinemaja.
39. Një pjesë e ansambilit.
41. Diftong teatral.
43. Të parat në stacion.
44. Qendër në tour.
46. Mbarojnë fare.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

1. Harris aktor.
3. Termocentrali i shkurtër.
5. Organizata me koska.
10. Një tufë bagëtish.
12. Inicialet e Redford.
14. Kështu thonë se bëhet ai që mërzhitet.
15. Scarlet e Bashkë e erën.
17. Elvira aktore.
19. Është Panorama që ke në dorë.
21. Ushtojnë nga "ola".
22. Shtet aziatik.
24. Është ministri.
25. Në radhtë të parë.
26. G... për njerëzit e FBI.
27. Makina Micra.
31. Mund të jetë proteste.
32. Pasur pa kufij.
33. Gjika e Dora d'Istria.
36. Të fundit në dhjetor.


VERTIKAL

1. Umberto që shkroi Baudolino.
2. Bertë këngëtare italiane.
3. Fillojnë një temë.
4. Një garë në hipodrom.
6. Qe burri i parë.
7. Një ndricues.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. I dha fillin Tezcut.




10. Vihen për të mbyllur.
11. Para Saint-Germain në futboll.
13. Qëllon në një vend.
16. Është dosja e të pandehurit.
17. Janë përmasat.
18. Mbush në kufij.
20. I bëjnë duart me ar.
21. Inicialet e dali piktor.
23. Fillojnë argumentin.
28. Makina Ibiza.
29. Emri i Einstein.
30. Ndricojnë rrugët.
31. Kim që qe aktore.
32. I hedh i dorzuar.
34. Inicialet e Nolte aktor.
35. Ishin rapsojë të akejve.
37. Fund shkurti.
40. Van der portier holandez.
44. Fillojnë masat.
46. Inicialet e Rohmer.
47. Fillojnë teorikisht.
49. Numër i shkurtër.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

9	5			6	2			8
4	6	3	7					
		1		4			9	7
		2		3	1			
	3	8				7	5	
			5	8		2		
8	4			1		5		
					9	4	6	2
7			6	5			3	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	5	9	8	2	1	6	7	3
8	6	3	7	4	9	5	2	1
7	1	2	3	5	6	4	8	9
5	8	1	9	7	3	2	6	4
6	2	7	4	1	8	3	9	5
3	9	4	2	6	5	8	1	7
2	4	8	1	3	7	9	5	6
9	7	6	5	8	4	1	3	2
1	3	5	6	9	2	7	4	8


Argëtim filozofik

- Nëntë të dhjetat e zgjuarsisë qëndron në të qënit i mençur në kohën e duhur. (Teodor Ruzvelt)
- I mençuri ka një prirej të fortë për të qenë i heshtur, dhe aftësinë për të ruajtur një inventar të tërë sekretesh. Zotësia dhe karakteri i tyre janë për t'u respektuar. (Baltazar Gracian)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Të hëniet të mençura

- Askush nuk mund të emancipohet nëse nuk emancipon njëherazi të gjithë ata që ka rrotull.
- Jeta është përsosje pa fund. Të quash veten të përsosur, do të thotë... të vrasësh veten. JOHANN P. HEBEL Shkrimtar (1760-1826)
- Kujdesi shpie në përjetshmëri, moskujdesi në vdekje; të kujdesshmit nuk vdesin kurrë, të pakujdesshmit janë si të vdekur.
- Nëse doni të arrini ndriçimin, nuk duhet të studioni mësimë të panumërtë.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

